

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

05.06.2023
Ora 10:44

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 76 subjekti ankues:
Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. 1. Kundërshtimi i vendimit nr. 533, datë
18.05.2023 për miratimin e tabelës përmbledhëse për Kryetarë të Bashkisë
Belsh. 2. Rinumërim dhe rivlerësim i votave të të gjithë QV-ve, Bashkia Belsh.
3. Pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në QV nr. 2565/01 IEVP Burgu
Kosovë, Bashkia Belsh.

PJESËMARRJA :

KAS: Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Ledio BRAHO, Z. Koli BELE.

Stafi KQZ: Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.

Partitë: BF, PS

Të tjerë: Ivi Kaso, Bedri Qypi

Z. L. Braho: Mirmëngjes të gjithëve. Çelim seancën për gjykim administrativ, për kërkesën ankimore numër 76, ku ankues është subjekti zgjedhor Koalicioni ‘Bashkë Fitojmë’, me objekt ankimimi ‘kundërshtimin e vendimit 533, të datës 15.05.2023, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh, për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, etj., sa i përket objektit të ankimit. Seanca e kaluar u ndërpre me qëllim që t’i jepej kohë palës ankimuese për të kqyrur gjithë materialet filmike që kishte marr nga KQZ-ja për shkak të afatit të shkurtër që kishte në dispozicion për kqyrjen e këtyre materialeve filmike, po ashtu ndërprerja e seancës u shfrytëzua dhe nga KAS për t’i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në lidhje me disa elementë të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

votimit të të burgosurve në burgun e Kosovës, më konkretisht Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, KQZ-ja i është drejtuar në datën 31.05.2023 me shkresën me numër protokolli 56/65 Drejtorisë së Përgjithshme të burgjeve dhe kjo e fundit ka kthyer përgjigje në lidhje me pyetjet e bëra nga KAS, në datën 1.06.2023, përgjigje që është administruar dhe sapo i është vënë në dispozicion dhe palëve që janë pjesë dhe e shqyrtimit administrativ, pra subjektit zgjedhor Koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe palës së interesuar subjektit zgjedhor Partia Socioaliste. Tani përderisa palët njihen, si fillim trupa e KAS-it është e përbërë në mënyrë të plotë me pesë anëtarë, të pranishëm janë përfaqësuesit e subjektit ankimues së bashku me kandidatin e mbështetur prej tyre, po zoti Nuri, po faleminderit, po ashtu dhe përfaqësuesi i Partisë Socialiste të Shqipërisë. Përpara sesa të vijojmë keni ndonjë kërkesë paraprake për seancën e sotme?

Përfaqësuesit: Jo.

Z. L. Braho: Jo, atëhere në lidhje me kohën që ju la për kqyrjn e të gjitha materialeve filmike dhe për të na sjellë fizikisht në formën e fotografisë, prova që kanë të bëjnë me vlerësimin e fletëve të votimit nga grupet e numërimit përsa i përket KZAZ-së Belsh.

Z. F. Nuri: Po, faleminderit i nderuar zoti relator, në lidhje me detyrat që KAS-i na la herën e kaluar për Bashkinë Belsh, ja ku kemi paraqitur sot pamjet filmike, fotografitë, të ekstrakuluara nga kamerat e Qendrave të Votimit që na janë vënë në dispozicion nga vet KQZ-ja. Këtu kemi një seri fotosh që mund t'i shihni që janë quajtur vota të vlefshme, që ato në gjykimin tonë duhet të jenë të pavlefshme. Votat janë në favor të kandidatit të Partisë Socialiste në Bashkinë Belshit, ja ku kemi këtu

***Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

një rast për shembull, që është një shenjë që s' duhet të jetë e tillë, kemi mjaft raste me shenjën A, që është votuar mbi germën A përbri kutisë përkatëse, kemi disa pulla, kemi disa vota me shenjën A, kemi një votë me shenjën Partia Socialiste dhe kjo është quajtur e vlefshme, kemi një votë me pikëçuditëse, një me shifrën 1, një tjetër me pikëçuditëse, një me firmë, me nënshkrim që del dhe jashtë kutisë, një tjetër me X dhe me shënimin 'Fitore' poshtë që e bën të identifikueshme fletën, kemi të tjera, këtu është nënshkrimi i personit jashtë kutisë dhe kjo është quajtur e vlefshme, këtu është një shenjë e çuditshme që nuk e di, po ta shikoni ngjason si me shenjën e Euros, nuk e di është quajtur e vlefshme dhe kjo, kemi dhe një pikëpyetje dhe ca zhgarravina.

Z. L. Braho: Sa fletë votimi janë gjithësej?

Z. F. Nuri: Këtu kemi shenjën, shifrën 10 a diçka e tillë, ne identifikuar herën e fundit që ishin mbi 60, këtu kemi sjellë nja 22-24 si shembull. Kjo është pikëpyetje, pikëpyetje te kutia përbri kandidatit të Partisë Socialiste, vota është konsideruar dhe e vlefshme dhe kjo shenja këtu është quajtur plotësisht e vlefshme që siç shihet është një zhgarravinë. Kemi gjithashtu edhe pamje filmike të shkurtrëra që dëshirojmë t'ua vënë në dispozicion t'i shohim të gjithë nëpërmjet monitorit.

Z. L. Braho: Çfarë pamjesh janë ato, domethënë çfarë kamerash?

Z. B. Qypi: Është një video e Qendrës 65 64 ku në kuti janë 2 fletë më shumë sesa janë shkruar në procesverbalin e numërimit.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. L. Braho: Edhe njëherë, pra është video e KZAZ-së gjatë numërimit, jo video e Qendrës së Votimit gjatë ditës së zgjedhjeve.

Z. B. Qypi: Jo, video e Grupit të Numërimit, ku në video del kandidati Bashkë Fitojmë ka 66 vota, në procesverbal është hedhur 64 vota.

Z. F. Nuri: Pra rezulton se janë hequr 2 vota kandidatit tonë.

Z. L. Braho: Administrata gjithësej sa kohë na duhet që ta shohim këtë video?

Z. B. Qypi: Po e depozitojmë, gjithsesi ju e vlerësoni vet.\

Z. Y. Merkaj: Çerek ore.

Z. L. Braho: Dakord, po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Në tabelën që na keni dhënë herën e kaluar janë të dhëna që kanë lidhje me Qendrën e Votimit 25 64 dhe 25 65. Këto vota që keni identifikuar ju i keni të printuara me grupin e votave që sollët?

Z. F. Nuri: Të 64-ës jo.

Z. I. Rusmali: Të 64 jo, të 65 i keni?

Z. F. Nuri: Sa ishte numri i Qendrës dhe njëherë.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. I. Rusmali: 25 65. 25 64 dhe 25 65

Z. F. Nuri: Po, 25 65 kemi një me gërmën U.

Z. I. Rusmali: Jo, nuk është ajo që keni evidentuar, më interesonte të dija te rasti i votave ku nuk duket vula, janë dy Qendra Votimi që...

Z. B. Qypi: Ato nuk i kemi dërguar, ato pavulë, për arsye i kemi lënë që ato janë në kuti, kur të hapet kutia t'i shohim sesi është e vërteta.

Z. I. Rusmali: Po ju i keni parë nga pamjet video?

Z. B. Qypi: Patjetër, kutia 25 64 gjatë gjithë procesit shumë fletë janë ku vula nuk dallon fare dhe në disa raste dallon shumë, shumë pak. Pra aty ka një mospërputhje të fletëve të votimit të gjetura në kuti me procesverbalin e numërimit.

Z. I. Rusmali: Nejse, s'ka rëndësi, mua me intereson kjo që paraqitet rradhën e kaluar, rradhën e kaluar ju folët për të dy Qendrat e Votimit për gjithësej 11 vota, të cilave nuk u duket mirë ose nuk u duket fare vula, eventualisht, dhe unë desha të shoh nga ato a ka gjurmë vule apo s'ka gjurmë vule. Nëqoftëse nuk e keni, nuk e keni.

Z. L. Braho: Po zoti Nuri, ndonjë gjë tjetër përveç videos?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. F. Nuri: Përveç videos dhe fotografive kemi dhe një të fundit me shenjë F këtu që konsiderohet e vlefshme, një me shenjë U dhe pak a shumë këto janë. Tani mund t'ua vë në dispozicion dhe administratës, por kemi dhe diçka, kemi dhe disa parregullsi të tjera, në mënyrë të përmbledhur duam t'i evidentojmë, që kanë dalë nga shqyrtimi i Qendrave të tjera të Votimit. Është Qendra e Votimit 25 62, ku janë gjetur në kuti 144 fletë votimi gjithësej, kurse në procesverbalin e Grupeve të Numërimit janë evidentuar 142 fletë votimi, pra ka problematikë, sipas pamjeve filmike rezulton se zoti Bedri Qypi, kandidati jonë, ka 66 vota ndërkohë që në procesverbal për të janë shënuar 64, pra nga provat dhe faktet kemi pamjet filmike që tregojnë dy vota të hequra të kandidatit tonë. Gjithashtu në Qendrën 25 64, ka problematika dhe kjo Qendër Votimi, në procesverbalin e fletëve të votimit janë shënuar 352 fletë votimi në kuti, ku 139 për zotin Arif Tafani, 200 për zotin Bedri Qypi dhe 13 janë të pavlefshme, por nga fletët e gjetura në kuti rezulton 357, nga të cilat 159 për zotin Arif Tafani, 200 për zotin Bedri Qypi dhe 18 të pavlefshme dhe jo 13 por 18 të pavlefshme. Dhe një problematik tjetër në Qendrën e Votimit 25 73, që ka rezultuar kjo problematikë pas kqyrjes së pamjeve filmike, në procesverbal të Grupeve të Numërimit janë shënuar fletë votimi të gjendura në kuti gjithësej 256, por pas pamjeve filmike rezulton se janë 258, pra 2 fletë votimi më shumë sesa janë shënuar në procesverbalin e Grupeve të Numërimit, gjithashtu së fundmi dhe Qendra 25 51, ku nga pamjet filmike rezultojnë të jenë numëruar 299 fletë votimi dhe në procesverbalin e Grupeve të Numërimit janë shënuar 301, kësaj rradhe janë shtuar 2 fletë votimi më shumë. Këto kishim si problematika, mund t'ua vë në dispozicion.

Z. L. Braho: Po, ju lutem na paraqisni dhe fletët e votimit që i keni në format fotografie dhe këto pretendimet e tjera. Në lidhje me shkresën e ardhur nga Drejtoria

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

e Burgjeve keni ndonjë prapësim për momentin apo do e bëni në momentin e konkluzioneve?

Z. I Kaso: Faleminderit i nderuar, shumë shkurt nga sa patëm mundësi të njihemi, shkresa, përgjigjia le të themi, i jep Komisionit Qendror të Zgjedhjeve gjithë informacionin e kërkuar, përveç faktit të informacionit të kërkuar në pikën e fundit ku Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve specifikon le të themi, që asnjë nga të dënuarit nuk përfshihet në ndalimet sipas nenit 2, të ligjit 138/2015, pa u dhënë detaje më të shumta, por nuk kemi arsye ta vëmë në dyshim, ajo çka bie në sy është fakti që edhe përsa i përket diskutimit që u ezaurua gjerësisht besoj, lidhur me të drejtën e këtyre shtetasve për të votuar në institucionet e vuajtjes së dënimit, qoftë sipas parashikimeve të ligjit bazë le të themi, që rregullon çështjen e vendbanimit dhe vendqëndrimit, që është Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë ashtu edhe me specifikimet ose detajimet që ka bërë lidhur me këtë çështje ligji për gjëndjen civile në nenin 18 të tij vërejmë që ka mjaft raste kua snjë prej të dy parashikimeve nuk përmbushen, le të themi, për 24 shtetësit të cilët janë paisur me vendim gjyqësor për të votuar në këtë Qendër të Posaçme, duke filluar që nga numri 1 i listës ku shohim që kemi të bëjmë me një të dënuar i cili është transferuar në këtë institucion të vuajtjes së dënimit në datën 8.04.2023, pra mbasi është mbyllur porçesi i hartimit të listave zyrtare të zgjedhësve dhe në asnjë mënyrë në bazë të asnjë parashikimi të asnjë ligji, të asnjë Kodi të Republikës së Shqipërisë nuk mundet kurrsesi t'i shkonte në mënd të votonte në këtë institucion të vuajtjes së dënimit dhe jo më t'i bëhej efektive kjo e drejtë, por gjithsesi në momentin që do të ndalemi, konkluzionet do ta detajojnë, si të tilla ka mjaft raste, u ndala te numri një se menjëherë binte në sy. Duke u ndalur te fillimi i përgjigjes, më pas duhet të vazhdonim me numrin 7, nuk po i përmënd emrat e të dënuarëve se s'ka ndonjë arsye, por numri rendor 7, numri

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

rendor 16, numri rendor 20, 21, 23 dhe 24, që as atë parashikim të detajimit që ligji i Gjëndjes Cilile ka bërë lidhur me atë vendqëndrimin më të gjatë se 3 muaj që të kthehej në vendbanim për efekt votimi, panvarësisht detyrimeve të tjera që duhet të kishte plotësuar administrata e burgjeve, formalisht as atë nuk e plotëson. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Kaso! Ju zoti Legisi në lidhje me këto qëndrime deri tani të palës ankimuese, keni ndonjë gjë lidhur me provat dhe me shkresën e burgjeve nëqoftëse keni ndonjë dicka.

Z. M. Legisi: Po, faleminderit. Në lidhje me provat e depozituara meqënëse kërkohet njëfarë vlerësimi i elementëve të fletës së votimit mbi vlefshmërinë e tyre apo pavlefshmërinë e tyre kërkoj që të paktën të kemi dhe ne një kopje, ndërsa përsa i përket drejtorisë së burgjeve do japim qëndrimin, tonë, në konkluzionet përfundimtare. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, ju lutem jepini një kopje të provave që depozituat sot ose t'i kqyri ato që janë dhe në vijim jepni kopjen. E kemi gati videon? Atëhere zoti Nuri nqs orjentoni pak administratën drejt videos që duhet hapur dhe çfarë duhet të shohim. Pra ideja e kësaj video është që ne po të numërojmë gjithë fletët që kalon ai në kamera janë 2 më...

Z. I Kaso: Ideja është që në kutinë e votimit janë 144 fletë dhe në grupin e numërimit janë shkruar 142, ku nga këto kandidati Bedri Qypi ka 66, në procesverbal është shkruar 64.

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit, e kuptuam. E pezullojmë 5 minuta seancën derisa të na vihen në dispozicion provat që t'i kqyrim dhe më tej do rifillojmë. Mirë atëhere çelim sërish seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 76, u vumë në dijeni me provat. Ka ndonjë pyetje nga kolegët për provat e paraqitura nga pala ankimuese?

Z. K. Bele: Kam një pyetje më shumë për avokatin, ose zotin Kaso, nuk e di, në zgjedhjet e mëparëshme ato të vitit 2021, është bërë një procedurë masive e hapjes së kutive dhe ndoshta ju keni qënë pjestarë ose mund ta keni ndjekur dhe praktika e vendosur në KAS konfirmuar dhe nga Kolegji Zgjedhor për aq sa ankime ka patur, por nuk është më shumë praktikë nga KAS-i, ka qënë më shumë në drejtim të vlerësimit të fletëve të votimit. Shënjat A, - , ? , !, janë quajtur të vlefshme si për kandidatët e secilës forcë politike, dhe panvarësisht nga gjetja sporadike e tyre, është parë se ato nuk kanë sjellë ndryshime në rezultat, pra ky ju kujtoj që është hapur mos qofsha i gabuar, gjithë Durrësi, njëqind e ca apo 200, dhe gjithë Berati dhe panvarësisht se ka patur nga këto shënime nga të gjitha votat të votuara për forca të ndryshme politike, ato janë konsideruar të vlefshme, mbasi janë të vlefshme, ligji e përjashton, pra sygjerohet X apo +, por nuk bëhet fleta e pavlefshme dhe nuk e dini ku mendoni që do ndryshoj ky rast nga eventualiteti që do kërkohet nga vlersësimi apo gjetja e votave në kuti, pa paragjykuar vendimmarrjen e KAS-it apo procedurat e mëtejshme. Në rastet ku del qartë vullneti i votuesit, pra mund të ketë votuar në kuadرات nuk e di, mund të ketë votuar jashtë, mund të ketë votuar në vizë, pra të identifikuar votat në procesin e mëparshëm kanë patur këtë tipologji. Çfarë mendoni se do ndryshoj sot?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. I Kaso: Faleminderit për pyetjen, në rradhë të parë nuk kam asnjë gjykim apo mendim çfarë mund të ndryshojë sot ose nesër lidhur me një standart që KAS-i e ka krijuar, sikurse ju i referuar vet, në zgjedhjet e vitit 2021, të cilën e kam ndjekur nga larg pasi të dy ankimet në atë rast të cilat ju referuat i ka bërë një subjekt tjetër dhe sigurisht nga më afër i kanë ndjekur vëzhguesit dhe përfaqësuesit e tyre në atë proces. Gjithsesi unë vlerësoj që përsa i përket shenjave të cilat ju i referuat ato, pa paragjykuar standartin që keni mbajtur dhe nëqoftëse do ta mbani dhe në këtë rast ose jo.

Z. K. Bele: Është standart i mbajtur nga KZAZ.

Z. I Kaso: Nga KZAZ-të, qoftë dhe nga KAS-i, nuk ka ndonjë rëndësi, standarit është i rëndësishëm, sikurse është i rëndësishëm dhe identifikimi i qartë i vullnetit të zgjedhësve, përsa kohë, dhe besoj që ky është standart që është mbajtur që në krye të herës, qëkur kanë filluar proceset e rinumërimeve, rivlerësimeve në organin epror që drejton procesin zgjedhor, përsa kohë le të themi, vullneti i shprehur qartë nuk lejon identifikimin e zgjedhësit i cili e ka shprehur atë vullnet. Qartësisht në pjesën më të madhe të rasteve, le të themi kemi një vullnet ndoshta, jo ndoshta po me shumë gjasa, të diktuar dhe të kontrolluar dhe të kontrollueshëm, pasi përsa i përket shenjave specifike të cilat janë vendosur në dallim nga shenjat uniformë të cilën sygjeron në manualët e veta, por dhe në reklamën që bën dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, uniformiteti i shenjës së shprehjes së vullnetit ka një qëllim, pikërisht për ta bërë të padallueshëm vullnetin e shprehur qartë, në morinë e zgjedhësve që në atë Qendër Votimi shprehin vullnetin. Nëqoftëse vullneti është i identifikueshëm, qoftë nëpërmjet firmës apo nëpërmjet një shenje tjetër të posaçme që i është diktuar zgjedhësit, ne besojmë që këtu është cënuar rëndë parimi kushtetues i votës së lirë,

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

të barabartë dhe të fshehtë. Se në këtë rast nuk kemi të bëjmë as me votë të lirë, as me votë të fshehtë, vota që kontrollohet. Qartazi të gjitha rastet janë për kandidatin i cili ka rezultuar fitues me një grusht votash, qartazi kjo nuk është e rastit që kjo gjë i ndodh kandidatëve të pozitës, që kanë mundësinë dhe të diktojnë vullnetin e zgjedhësit para procesit zgjedhor, dhe të kenë instrumentat e kontrollit dhe më pas të raprezaljes nëqoftë se vullneti në kuti nuk është ai që është diktuar qoftë me joshje, qoftë me shtrëngi, qoftë me blerje, qoftë me gjithë format që pushteti zakonisht përdor dhe në proceset zgjedhore të fundit e kemi parë një agravim të kësaj situatë nga një proces zgjedhor te tjetri. Ky është vlerësimi im i përgjithshëm pa paragjykuar vendimmarrjen tuaj. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Kaso, atëhere nëqoftese nuk k apyetje të tjera mbetet për ankuesin, çfarë kërkon pas paraqitës këto provat e reja, kush është qëllimi i paraqitjes së gjithë këtyre provave?

Z. I Kaso: Faleminderit, sikundër e thamë dhe e referuam dhe në kërkesën tonë përpara se të mbyllej seanca, kërkojmë kqyrjen e materialeve të cilat nuk gjenden në disponibilitetin tonë, në kuadër të thellimit të hetimit administrativ, në bazë të nenit 136, pika 1,c, besojmë që materialet të cilat duhet të merren dhe të kqyren janë gjithë fletët e votimit të vlefshme për dy kandidatët, si dhe fletët e votimit të pavlefshme për të gjitha Qendrat e Votimit për këtë zonë zgjedhore. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Kaso!

Z. I. Rusmali: Neni 136 që referoni ju kërkon rinumërim dhe rivlerësim të votave, nëqoftëse nuk gaboj unë, kur votat janë kontestuar në proces. Keni ju kontestim

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

votash në proces, të vlefshme ose të pavlefshme? Ka dokumentacioni zgjedhor përmbajtje të tillë? Ka prova për këtë?

Z. I Kaso: Unë besoj që përveç asaj që u ndalën gjërësisht, të shënimeve të materialeve zgjedhore përse i përket kryesisht dokumentacionit të prodhuar nga KZAZ-ja, rinumërimi dhe rivlerësimi i parashikuar nga neni 138, mos gaboj, është një proces që vjen si pasojë e administrimit në rradhë të parë të materialeve, sipas nenit 136, pika 1, dhe materialet janë pikërisht ato që kemi kërkuar. Pastaj panvarësisht se neni 138 e lidh procesin e rivlerësimit dhe rinumërimin të votave të caktuara ë pjesën e parë të fjalisë, në pjesën e dytë të fjalisë, pra duke iu referuar qartazi votave të kontestuara, në pjesën e dytë të të njëjtës fjali, mos gaboj 133-shi, i referohet gjithashtu dhe pjesës tjetër të votave, pra ato që thotë që rezultojnë gjithsesi në tabelën e numërimit e cila është e kontestuar, pra nëqoftëse do të përfshihej gjithë ushtrimi që ne kërkojmë të bëjmë në një proces rinumërimi dhe rivlerësimi sipas nenit 138, pika 3 të tij, besoj ky proces duhet të prekte krahas votave të caktuara pra të kontestuara nga procesi i numërimit, edhe votat e tjera sipas parashikimit të pjesës së fundit të të njëjtës fjali. Faleminderit!

Z. I. Rusmali: Në provat që ju i vutë në dispozicion KAS-it ju tregoni për problematika me gjithësej ndoshta 20 Qendra Votimi, të cilat ju i keni evidentuar, ku mungojnë vota, ku nuk janë pasqyruar saktë në procesverbal, ku ka pavlefshmëri që është konsideruar vlefshme, etj. Pse kërkon rinumërimin dhe rivlerësimin e të gjithë zonës kur problemet i keni në 20 Qendra Votimi?

Z. I Kaso: Faleminderit, ne vlerësojmë që ato që kemi mundur të identifikojmë përmes procesit të kqyrjes së materialit filmik të kamerave në procesin e numërimit

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

janë vetëm ato që janë paraqitur para jush, janë Qendrat që mbarin problematikën më serioze që ishte e mundur të identifikohesh nga ana jonë nëpërmjet kqyrjes së këtij materiali. Vlerësojmë sipas informacioneve që kemi që edhe Qendrat e tjera janë të prekura nga i njëjti fenomen, ndonëse është më e vështirë që të identifikohen nëpërmjet materialit filmik. Kështu që kemi sjellë atë fillim të provës ose atë indicie në ato Qendra në të cilat problematika ka qënë më e theksuar, nga sa kanë mundur të vërjnë personat nga ana jonë që kanë kqyrur gjithë materialin filmik.

Z. I. Rusmali: Kjo do të thotë që për Qendrat e tjera ju keni informacione, nuk keni prova.

Z. I Kaso: Po ne besoj po të kishim provë të plotë në kuptimin e asaj që kërkon procesi ankimor, besoj që edhe kjo kërkesë jona domethënë, për marrjen e provës do të ishte e kotë sepse do t'i kishim provat, në kuptimin e asaj çka KAS-i kërkon, që të mos zgjatëshim le të themi në këtë proces hetimor por besoj që ne kemi fillimin e provave ose indicien që kërkon ligji, për të kërkuar në bazë të nenit 136, pika 1, c, thellimin e këtij hetimi dhe marrjen e këtij materiali, kqyrjen e tij, sepse vlerësojmë që prova është në kuti dhe e provojnë vetë fletët e votimit.

Z. I. Rusmali: Jo keni për këto Qendrat e tjera, për 20 Qendrat e tjera keni indicie. Në fillim ishte informacion, pse nuk na e bëni me dije ne, pse na e mbani sekret në këtë gjë? Për secilën Qendër Votimi informacionin që keni, për secilën prej tyre.

Z. I Kaso: Këtë informacion që i kanë ardhur kandidatit nga numëruesit që kanë qënë në proces, të cilët në disa Qendra në raportin 3 me 1, dhe, më falni në disa tavolina numërimi në raportin 3 me 1 dhe në disa tavolina të tjera në raportin 4 me

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

0, të cilët në një masë të madhe, panvarësisht se ligji zgjedhor nuk e lejon, janë të gjithë persona që janë në mardhënie pune kandidatit rival, i cili është dhe Kryetari i Bashkisë në detyrë dhe për këtë arsye nuk kanë preferuar që ta ndajnë këtë informacion zyrtarisht për të mospatur shqetësime në vazhdimin e karrierës së tyre përse kohë kryetari në detyrë është ende kryetar dhe i pakonfirmuar në pozicionin e kandidatit fitues për shkak të procesit të ankimor, kështu që janë informacione që i kanë shkuar kandidatit, por nga persona që qartazi kanë vështirësi për ta ndarë.

Z. I. Rusmali: 20 Qendrat e tjera keni informacionin që anëtarët e Grupeve të Numërimit janë në mardhënie punë me kandidatit. Ky është informacioni që keni?

Z. B. Qypi: Dhe në ato Qendra nga verifikimet që kemi bërë ka mospërputhje të tabelave.

Z. I. Rusmali: Pse nuk na e tregoni, pse nuk na e thoni ne? Pse e mbani sekret?

Z. B. Qypi: Tani në takimin e parë na thatë duam ca raste dhe jo problematikat për gjithë degën, dhe për fletët e votimit thatë 3-4 raste.

Z. I. Rusmali: Ne hapim procesverbalin e mbledhjes tonë, por nuk del asgjëkundi që kemi thënë ca raste.

Z. B. Qypi: Në të gjitha Qendrat ka mospërputhje.

Z. I. Rusmali: Pse nuk na i tregoni?

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. B. Qypi: Tani unë nuk kam as ekip, as kështu, çdo gjë e kam bërë me

Z. I Kaso: Besoj se për efekt të kohës zoti Rusmali kaq kemi arritur të nxjerrim, domethënë në këtë moment, dhe besoj se këto janë prova të mjaftueshme për të kuptuar KAS-i që ka problematika. Sot te fleta që unë relatova në fund 4 Qendrat e Votimit ishin Qendra që ishin evidentuar mbas kqyrjes së kamerave nga seanca e mëparëshme e javës së kaluar deri në fundjavë, pra janë element të tjerë që kemi gjetur. Gjykoj se provat janë të mjaftueshme për t'i hapur të gjitha Qendrat e Votimit dhe për t'i rivlerësuar të gjitha. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Nuri, besoj se jemi të qartë në lidhje me provat që keni. Zoti Legisi ju lidhur me këtë kërkesë të përsëritur tashmë të palës ankimuese, në lidhje me kqyrjen e të gjitha fletëve të votimit, të vlefshme dhe të pavlefshme për çdo Qendër Votimi të Bashkisë Belsh, çfarë qëndrimi keni?

Z. M. Legisi: Faleminderit i nderuar! Ne, subjekti zgjedhor Partia Socialiste, është për transparencë në këtë proces, në lidhje me kërkesën për të hapur të gjitha kutitë e votimit dua të them këtë, pavlefshmëritë e konstatuar në këtë Qendër Votimi janë paligjshmëri të konstatuara vetëm në atë Qendër Votimi dhe kjo nuk do të thotë që në Qendrat e Votimit të tjera të kësaj KZAZ-je kanë ndodhur po të njëjtat. Vumë re që nga provat e depozituara të fletëve të votimit, që u përzgjedhën në sasinë, në formën dhe në cilësinë e dëshiruar nga pala, që ajo e ka vlerësuar që janë në favorin e saj, në vlerësimin tonë nuk janë të tilla aspak. Fleta e votimit është një moment, është një akt, dhe le të themi votimi është një moment shumë i veçantë ku përcillet pushteti nga qytetari te pushtetarët le të themi, te Kryetari Bashkisë, në rastin konkret dhe të kufizosh këtë moment dhe ta detyrosh apo t'ja bësh të pavlefshme këtij

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

qytetari vullnetin e tij të bërë me X apo me një +, sipas shenjës së referuar nga ana e KQZ-së përgjatë reklamimit të mënyrën sesi duhet votuar, ne e vlerësojmë totalisht të pavënd. Pra ky është momenti i vetëm në të cilën qytetari përcjellë pushtetin e tij te Kryetari i Bashkisë. Referimi apo insinuata të tilla që këto janë shenja që të japin, apo të tregojnë që ka një presion nga jashtë etj, etj, këto janë sigurisht janë pretendime që të çojnë në shkelje jashtë Qendrës së Votimit dhe nuk korenspondojnë me kërkimin. Në vlerësimin tonë provat sigurisht që duhet të pranohen dhe e lëmë në gjykim të KAS-it hapjen ose jo të kutive. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit zoti Legisi, po zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Unë kërkoj nga administrata të më vëj në dispozicion vendimin gjyqësor të plotë, jo ekstraktin që na ka vënë, për këtë personin që në listë është me numrin 9.

Z. L. Braho: Për sa mund të bëhet gati ky vendim zoti Merkaj? Madje përveç 9-ës me kërkesën time shtoni dhe 1-shin edhe 6-ën, që janë te lista që ka sjellë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Mirë atëhere KAS do tërhiqet për vendim në lidhje me kërkesën për kqyrjen e të gjitha provave në lidhje me fletët e vlefshme, të pavlefshem të Bashkisë Belsh. Për 10 minuta rikthehemi.

Përshëndetje dhe njëherë, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 76. KAS pasi u tërhoq për vendim, me shumicë votash vendosi rrëzimin e kërkesës së ankuesit të subjektit zgjedhor të Koalicionit 'Bashkë Fitojmë', në lidhje me kqyrjen e provave që janë gjithë fletët e votimit të vlefshme dhe të pavlefshme, për zgjedhjet e Bashkisë Belsh. Megjithatë meqënëse kërkesa e subjektit ankimues është bërë në bazë të nenit 136, pika 1, shkronja c, e Kodit Zgjedhor, 2 anëtar të

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

KAS, në zbatim të pikës 3 të po këtij neni, më konkretisht unë dhe zoti Elvis Çefa, i kërkojmë KQZ-së që të paraqis në cilësinë e provës të gjitha kutitë e votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023, për Bashkinë Belsh, dhe të gjitha kutitë e votimit që kanë të bëjnë me zgjedhjen e Kryetarit të Bashkisë Belsh. Seanca për kqyrjen e këtyre provave do të lihet nesër, në datë 6 qershor, në ora 13:30. Seancën ë deklarojmë të mbyllur!

*Zbardhi materialin audio
Andoneta GJIKNURI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

05.06.2023
Ora 12:12

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 85, subjekti ankues:
Koalicioni “Bashkë Fitojmë”.

1-Rinumërimin dhe rivlersimin e votive në QV nr. 2373/01, nr. 2481/01 dhe nr.
2483/00 Elbasan.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, Z. Ilirjan Rusmali,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj, D. Alimemeti.
- **Parti Politike:** BF (F. Nuri, B. Himçi), PS (M. Legisi, E. Salianji).
- **Të tjerë:** KRIIK

Z. L. Braho: Atëherë përshëndetje, riçelim seancën për shqyrtimin administrativ të kërkesës ankimore numër 85, me ankues subjektin zgjedhor Koalicionin Bashkë Fitojmë dhe me objekt ankimi kundërshtimin e vendimit numër 539, datë 20.05.2023, për miratimin e tabelës përmbledhëse për rezultatet për zgjedhjet për kryetarin e bashkisë dhe për këshillin bashkiak zona zgjedhore Bashkia Elbasan për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, pavlefshmërinë e zgjedhjeve të zhvilluara në zonën zgjedhore Bashkia Elbasan. Në seancën e kaluar me kërkesë subjektit ankimues dhe me vendimarrje të KAS-it u vendos që të mbikqyreshin fletët fizike në qendrat e votimit 2373/1, 2484/1 dhe 2483 po ashtu j'u la detyrë administratës së KQZ-së që t'i vinte në dispozicion palës ankimuese të gjithë procesverbalin dhe marrjes në dorzim nga KQV-ja në

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

favor të KZAZ-së, të KZAZ-së numër 47 në lidhje me pretendimet që kjo palë kishte për mungesën e vulave të sigurisë, sot është i pranishëm një nga përfaqësuesit e subjektit zgjedhor të Koalicionit Bashkë Fitojmë.

Z. F. Nuri: Po, Franci Nuri prezent dhe ndërkohë zoti Himçi është duke ardhur.

Z. L. Braho: Po ashtu është prezent edhe përfaqësuesi i palës së interesuar subjekti zgjedhor Partia Socialiste, prezent është edhe Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, trupa e KAS-it përbëhet nga katër anëtarë për zhvillimin e kësaj seance plotësohet kourumi për zhvillimin e saj. Palët kanë ndonjë kërkesë paraprake? Jo, po ashtu shohim që janë ngritur tre tavolina numërimi nga administrata e KQZ-së për kqyrjen e fletëve të votimit në tre qendrat e votimit që cituam më parë, është tavolina e numërimit numër 4, 5, dhe 6, zoti Merkaj na thoni kush qender votimi është ke cila tavolinë për transparencë.

Z. Y. Merkaj: Atëherë sipas rregullores së KAS-it kemi tre grupe numërimi në përbërje të së cilës janë Klodiana Nogu dhe Eljo Rama tek grupi i numërimit të 4, te grupi i numërimit 5 është Lorena Mavriqi dhe Sara Gjikhuri dhe grupi i numërimit numër 6 është Ambra Agolli me Panajot Shahon, qendrat e votimit janë që do të numërohen 2373/1, 2384/1, 2483, atëherë 2373/1 është tek grupi i numërimit numër katër.

Z. L. Braho: Atëherë edhe njëherë 2373/1 është tek grupi i numërimit 4.

Z. Y. Merkaj: Jo, është tek 6-ta.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. L. Braho: Është tek 6! 2481/1?

Z. Y. Merkaj: Është tek 5-sa, 2483/00 është tek 4.

Z. L. Braho: Mirë faleminderit! Janë njoftuar subjektet zgjedhore që janë palë për vëzhgues?

Z. Y. Merkaj: Po, janë njoftuar nuk i kanë sjellë akoma vëzhguesit, presim nga ju urdhërimet. Të fillojmë apo jo?

Z. L. Braho: Po faleminderit! Zoti Nuri çfarë mendimi keni me faktin që nuk ka vëzhgues?

Z. F. Nuri: Mund të fillojmë i nderuar!

Z. L. Braho: Mund të fillojmë, dakord. Edhe për ju zoti Legisi?

Z. M. Legisi: Po, dakord!

Z. L. Braho: Dakord, mirë atëherë meqënëse të gjitha elementët janë gati atëherë grupet e numërimit le të fillojnë kqyrjen e fletëve të votimit, për këto qendra votimi. Atëherë meqënëse në këto kuti ka edhe fletë për kryetarë bashkie dhe fletë për këshill bashkiak, ajo që është në interes të votimit është ajo që ka të bëjë me

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

rezultatit, ose më saktë me kqyrjen e fletëve të votimit për kandidatët për kryetar bashkie. Grupet nisin nga puna dhe në vijim për çdo paqartësi mund të vijojmë.
(Hapen kutitë dhe lexohen kodet e tyre duke u konfirmuar nga zoti Y. Merkaç)

Rifillon seanca

Ora 13:23

(I pranishëm në këtë seancë dhe zoti E. Çefa)

Z. L. Braho: Përshëndetje edhe njëherë, riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 85, me ankues Koalicionin Bashkë Fitojmë për rezultatit për Bashkinë e Elbasanit, atëherë u rivlersuan fletët fizike në qendrat e votimit 2373/1, 2481/01 dhe 2483/00 dhe nga rivlersimi dhe rinumërimi i fletëve fizike për kryetar bashkie rezultoi se ato përputhen plotësisht me rezultatit e transmetuar nga pajisjet elektronike në sistemin e KQZ-së, më konkretisht në qendrën e votimit 2373/1 rezultati gjithmonë flasim për kryetarët e bashkive ishte për zotin Gledian Llatja 161 vota dhe aq ka rezultuar nga fletët fizike po 161 vota. Për zotin Luçjano Boçi 144 vota ishin dhe 144 kanë rezultuar nga votimi fizik, edhe vota të pavlefshme ishtë 7 dhe është po sërish 7, për qendrën e votimit 2481/1 rezultati për zotin Gledian Llatja ishte 136 vota dhe është sërish 136 vota, për zotin Luçjano Boçi ishte 113 dhe nga fletët fizike del po 113, ndërkohë vota të pavlefshme ishin 8 dhe janë po 8, tek 2481/1, pra përputhet. Për qendrën e votimit 2483 numri i votave për zotin Gledian Llatja ishtë 189 dhe është 189 edhe nga fletët fizike, për zotin Luçjano Boçi ishtë 90 dhe është 90 dhe me fletët fizike, ndërkohë vota të pavlefshme siç ishin 7 po aq rezultuan 7 edhe me fletët fizike. Ky është rezultati i kqyrjes së provave të këtyre tre qendrave të votimit që me vendim të KAS-it u vendos të rivlersoheshin. Meqënëse ka ardhur edhe zoti Himçi, pyeta

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOÇAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

në fillim në lidhje me procesverbalet për KZAZ-në 47 për dorëzimin e materialeve.
I keni marrë nga KQZ-ja?

Z. B. Himçi: Përpara se të dalim tek pjesa për sa i përket procesverbaleve unë kisha thjeshtë një koment dhe dy pyetje, në lidhje me KQZ-në, unë e diskutova edhe herën e kaluar që ne në pretendimet tona do të donim që të bëhej edhe kqyrja e pajisjes elektronike nga ekspertë të IT-ve, për arsye se kam dy pyetje në lidhje me KQZ-në. Kompania që ka vendosur softëeret a është e çertifikuar ndërkombëtarisht dhe a ka çertifikatë sigurie për këtë proces? Pyetja tjetër është: Aka patur nënkontraktorë shqipëtar dhe a ka patur çertifikatë sigurie dhe çertifikatë të njohur ndërkombëtarisht për të instaluar softëeret në këto pajisje. Këto janë pyetje që do të kërkohen nga KQZ-ja të më sqaronte, faleminderit zoti Braho.

Z. L. Braho: Faleminderit! Në lidhje me rezultatin nuk besoj se keni kontestime? Atëherë nuk keni, ju me sa mbaj mend unë kishit bërë edhe një shkresë drejtuar KQZ-së, ku ngrinit një serë pyetjesh. Ju ka ardhur përgjigjia e kësaj shkrese nga KQZ-ja?

Z. B. Himçi: Kjo është shkresa jonë, nuk na ka ardhur asnjë përgjigje i nderuar, vazhdojmë mbesim pa përgjigje.

Z. L. Braho: Zoti Ylli Merkaj, një nga detyrat që lamë seancën e kaluar ishte edhe që të ktheni përgjigje, për shkresën. Këto dy pyetje janë pjesë e shkresës që keni dërguar ju? Këto dy pyetje që sapo cituat?

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. B. Himçi: Pyetjet kanë qenë më tepër pjesën e kamerave i nderuar dhe për arkitekturën e sistemit arkitekturës, duke filluar me hardëerat, softëerat dhe rrjetin me mënyrën se si është dizenuar pjesa e votimit, mbajtja e sigurtë në përfundim të procesit dhe në fund të numërimit që është pika 2 në pyetjet tona dhe kemi kërkuar që të testohet manualisht sistemi duke e provuar atë dhe duke i krahasuar me të dhënat që të ruheshin në Database, këto kanë qenë dy pyetje por njëkohësisht janë edhe këto dy pyetje shtesë që unë bëra tani i nderuar në lidhje me atë çka duam të qartësojmë në këtë proces.

Z. L. Braho: Tani zoti Himçi! Ju e njihni procesin se si funksionon dhe ne kemi kohë të kufizuar për kryerjen e hetimit administrativ dhe tani normalisht ju mund t'iu lindin pyetje sa herë ne mblidhemi, mund t'iu lindin pyetje, të bëni pyetje dhe i bie ne të japim kohë për t'iu përgjigjur çdo pyetje, nuk e di nëse mund t'i përgjigjet tani drejtoresha e IT-së këtyre dy pyetjeve por megjithatë unë i tërheq vëmendjen administartës së KQZ-së që të paktën shkresën siç u vendos rradhën e kaluar duhet të ja kishit kthyer përgjigjen e atyre pyetjeve, ndërkohë që për këto dy pyetjet e fundit nëse është mundësia për t'iu përgjigjur tani...

Znj. D. Alimemeti: Përshëndetje, në lidhje me procedurën, le të themi me shkresën që duhet të përpilonim, ne i kemi dërguar kërkesë kompanisë sepse në shumicën e materialeve janë proprietarë dhe kofidenciaklë dhe kemi dërguar imeil duke përfshirë të gjitha pyetjet që të marrin një përgjigje, le të themi të themi përgjigje të saktë dhe të plotë për tja u kaluar pastaj palëve që kanë bërë ankesën, kjo e para. Pjesa tjetër në lidhje me çertifikimin e kompanisë, kompania është e çertifikuar me IS-ën 27 mijë e njëshin që ka lidhje me sigurinë, me IS-ën 23 mijë që ka lidhje me

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

proceset, ka lidhje dhe çertifikata të tjera të cilat janë për punën e tyre, varet se çfarë kërkojnë të nderuarit, cilat janë çertifikimet. Dy nga çertifikimet që ne dimë janë dy elementë të rëndësishëm që është siguria dhe proceset në menaxhimin e proceseve dhe ju thashë më përpara 27 mijë e njëshi dhe 23 mijëshi janë le të themi të përfshira në ISO, në lidhje me pyetjen tjetër kishte lidhje me.... nënkontraktor jo, kompania nuk ka lidhje me nënkontraktor në procesin e instalimit, e bënë vetë pjesën e instalimit të pajisjeve dhe nuk ka nënkontraktor shqipëtar.

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Himçi besoj se për këto dy pyetje e morët përgjigjen. Po zoti Salianji.

Z. E. Salianji: Mesa dëgjova drejtoreshën, i përmendi çertifikatat besoj edhe për transparent është mirë që këto çertifikata besoj janë pranë Komisionit të KQZ-së t'i vihen në dispozicion edhe KAS-it edhe palës ankimuese, që ne këtë histori ta mbyllim njëherë e përgjithmonë që në ato makineri mund të mendohet që mund të ndërhyet, pale që ska ndërhyrje, prandaj këto çertifikata që ju thatë ju lutem patjetër që duhet të vihen në dispozicion të palëve.

Z. L. Braho: Po faleminderit, nuk besoj që edhe këto kanë qenë edhe pjesë e procedurës së prokurimit, këto çertifikimet. Zoti Himçi nuk më thatë për ato procesverbalet.

Z. B. Himçi: Për procesverbalet i nderuar, për pikën tjetër është KZAZ-ja 47, faktikisht ne kemi konstatuar në 30 qendra votimi, në 30 pajisje nga 101 qendra votimi apo 202 pajisje, në të cilat rezultoi të mbajtura me procesverbal, në qendrën

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

e votimit 2422 është pa vulë dhe pa kod, në qendrën 2391 është e padorëzuar me vulë dhe pa kod, në 2394 të njëra është pa vulë të tjetra një kod mungon, të 2470 janë pa vulë sigurie, të 2396 mungon një kod, të 2441 është e hapur por dhe e papërdorur mbajtur në procesverbal, vula është e hapur por e papërdorur, 2422/1 është pa vulë, 2426 dy kode mungojnë, të 2479 kutia është e hapur dhe është e vulosur me vulë rezervë, 2416 është pa vulë, të 2398 në procesverbal thuhet e papërdorur po kështu edhe ke 2463 thuhet e papërdorur, tek qendra e votimit 2395/1 është pa vulë, të 2385 është PEVN pajisja elektronike e votimit dhe numërimit numër 2 është pa vulë dhe kutia është bosh, të 2394/1 është pa një kod sigurie, të 2476/1 është pa një kod sigurie, të 2410 është e papërdorur, të 2415 mungojnë kodet e sigurisë së PEVN 2-shit dh ato kode janë të papërdorura, 2439 është e papërdorur mungojnë kodet e sigurisë së PEVN 2-shit, 2446 mungojnë 4 vula dhe kutia e hapur dhe është pa vulë PEVN 2, të 2390/1 është pa vulë pa kod, të qendra votimit 2450 është pa vulë, në qendrën e votimit 2456 pa vulë, qendra votimit 2449 pa vulë dhe i papërdorur kodi, 2384 i papërdorur kodi i PEVN 2, 2379 është pa vulë sigurie, të 2474/1 mungon një kod, të 2480 mungojnë 5 kode, të 2457 mungojnë 5 kode dhe të 2428 mungojnë kodet, kjo është i nderuar situata përmbledhëse në lidhje me provat dhe me qendrat e votimit në të cilat janë mbajtur edhe shënimet përkatëse në secilin procesverbal nga anëtarët e KZAZ-së, mund tju a vëmë në dispozicion i nderuar nëse doni t'i administroni.

Z. L. Braho: Po faleminderit, atëherë se di i ka gati administrata e KQZ-së këto procesverbalet.

Zbardhi materialin audio

Jonida KOCAQI



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. B. Himçi: Po i nderuar, faktikisht të gjitha janë mbajtur shënim në përmbledhësen përkatëse që t'i kërkon për çdo fletë për qendër votimi, prandaj kam bërë një përmbledhëse, çfarë kanë firmosura anëtarët e çdo qendre votimi për sa i përket pjesës së asaj që kanë konstatuar, i kemi referuar çdo procesverbali të mbajtur për parregullsit që kanë ndodhur në çdo qendër votimi momentin e dorëzimit.

Z. L. Braho: Atëherë administrata e KQZ-së të na sqaroj pak për të gjithë këto pretendime që ka ngritur pala ankimuese në lidhje me disa... janë 30 qendra votimi. Se materialet janë të parenditura.

Z. B. Himçi: KQZ-së i jepet gjithmon koha vetëm për ne ska kohë.

Z. K. Bele: Problemi është që pyetjet janë të natyrës teknike dhe ne pavarësisht se jemi këtu nuk e kuptojmë një vulë dy vula, se ato janë edhe më shumë me natyrë teknike mendoj unë, mbase disa janë dhe formale ndonjëra ka të bëjë me sigurinë po fakti që makina lidhet me 5 rripa dhe që është e lidhur me 4 rripa kutia, vetëm ju i ktheni përgjigje çfarë mendoni rast pas rasti, se unë nuk e di tipologjinë që janë gjëra, që vërtetë janë administrative pa zarar.

Z. E. Saliç: Ne këtu do të jemi të mbledhur gjatë gjithë kohës, siç tha dhe zoti Rusmali përgjigjia të dali tamam, të relatohet se nuk kemi çfarë përgjigje më the të thash dhe ne se kuptojmë, prandaj jemi të mbledhur gjatë gjithë ditës sot, ose lijeni sot mbasdite ose nesër në mëngjes.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Z. I. Rusmali: Ndoshta për të sqaruar pak zotin Himçi sepse komunikova jashtë mikrofonit me të, ne i kemi të gjitha palët njëloj dhe nuk ka nevojë për ta vënë në dyshim këtë gjë, ju paraqitët një listë me konstatime që ju i keni bërë duke parë procesverbalet e marrjes në dorzim të materialit zgjedhor është mëse normale që Sekretari i Përgjithshëm të maqrrë 10 minuta kohë zoti Himçi, jo 10 ditë, 10 minuta kohë që të indetifikojë për secilin prej tyre bashkë me stafin e tij ku janë problemet cila është domethënia dhe të na referojë ne nga pozicioni i KQZ-së. Kush është kuptimi i atyre konstatimeve? Ne nuk jemi ekspertët e asaj fushe, ne kemi nevojë t'i dëgjojmë të dyja palët për këtë qëllim, për të kuptuar nëse ka shkelje apo jo. Gjithsesi nëse Sekretari i Përgjithshëm është i gatshëm të na i japë përgjigjen tani, le të na i japë tani nuk ka asnjë problem.

Znj. D. Alimemeti: Të sqaroi një element, në KZAZ-në 47 janë dërguar... në të gjitha QV-të janë dërguar 2 pajisje por jo detyrimisht janë përdorur të 2 pajisjet dhe procesverbalet nuk bëjnë gjë tjetër vetëm se deklarojnë dy makineri për një QV dhe është përdorur vetëm 1, për arsye të vendit për arsye të numrit të vogël të votuesve, le të themi vlersimi i QV-së dhe është përdorur vetëm 1. Rastet që përmendi zotëria ne do ti evidentojmë një e nga një, po gjithsesi kanë të bëjnë me papërdorshmërinë e kutisë së PEVN-së 2, kjo është kryesisht.

Z. L. Braho: Tani ajo që na interson ne për efekt shqyrtimi duke u nisur edhe nga një rast që kishim edhe për Kamzën ishte që mungesa e një vule ishte konsideruar nga KZAZ-ja e Kamzës si e paregullt kutia dhe duam të dimë nga të gjitha këto që ka sjellë zoti Himçi si pretendime të tilla. A jemi në një rast në kushtet e parregullshmërisë së kutisë apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Janida KOCAQI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.05.06.2023*

Znj. D. Alimemeti: Jo, në momentin që nuk është përdorur pajisja nuk ka asnjë arsye pse të vuloset dhe pse të mbyllet.

Z. I. Rusmali: Drejtoreshë ky është një rast zoti Himçi dha 30 raste në mos gabojë, ja po i lëmë 29, ky është një rast. Ke dhënë përgjigjen për të 30-ta apo për 1?


Znj. D. Alimemeti: Unë po përgjithësoj!

Z. I. Rusmali: Jo nuk duam përgjithësim, duam të marrësh tabelën e zotit Himçi dhe për secilën prej këtyre të na japësh shpjegimin nga këndvështrimi i KQZ-së.

Z. Y. Merkaj: Atëherë kërkojmë më tepër kohë.

Z. L. Braho: Mirë atëherë pezullojmë seancën për 10-15 minuta deri sa administrata e KQZ-së të verifikojë materialin e sjellë nga ankimuesit.

*Zbardhi materialin audio
Jonida KOCAQI*



05.06.2023
Ora 13.54

RENDI I DITËS

**Projektvendimi “ Për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 80, subjekti ankues
koalicioni “ Bashkë Fitojmë”**

**Kundërshtimi i vendimit nr. 531, datë 18.05.2023 “ Për miratimin e Tabelës
Përmbledhëse të rezultatit për kandidat për kryetar, Bashkia Rrogozhinë”**

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin LAKO, Z. Elvis ÇEFA, Z. Ilirjan RUSMALI,
Z. Koli Bele, Z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Z. Ylli Merkaj, Znj. I. Osmanaj.
- **Parti politike:** “Bashkë Fitojmë”, (F. Nuri, V. Gumi); Kandidati i BF-
së Shkëlqim Hoxha); PS (E. Memolla, M. Legisi)
- **Të tjerë:** **KRIIK**

Z. L. Braho: Ndërkohë që presim Elbasanin, çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 80. Ju lutem, mbani qetësi! Pra çelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore numër 80 me subjekt ankues koalicionin “Bashkë Fitojmë”, me objekt kundërshtimin e tabelës së rezultatit për Bashkinë Rrogozhinë. Me kërkesë të dy anëtarëve të KAS-it në seancën e kaluar u vendos që të këqyren të gjitha kutitë e votimit për kandidatët për kryetar bashkie. Ndaj sot janë ngritur nga administrata e KQZ-së 6 tavolina numërimi, me qëllim vlerësimin e të gjitha votave të vlefshme dhe të pavlefshme në qendrat e votimit të Bashkisë Rrogozhinë. Siç e kemi relatuar dhe në seancën e kaluar, secili nga subjektet zgjedhore palë në proces,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

ka të drejtën të sjellë dhe vëzhgues. Të pranishëm sot është një nga përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zoti Franci Nuri, janë prezent përfaqësuesit e Partisë Socialiste, Marenglen Legisi, Eridian Salianjim; është edhe vetë kandidati, gjithashtu si palë e interesuar është edhe kandidati i mbështetur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Trupa e KAS-it është e përbërë me numër të plotë me 5 anëtarë, i pranishëm është sekretari i Përgjithshëm, i KQZ-së. Zoti Merkaj, në lidhje me vëzhguesit, me tavolinat e numërimit, ju lutem na jepni sqarimet!

Z. F. Nuri: Franci Nuri, prezent.

Z. M. Legisi: Prezent.

Z. E. Salianji: Prezent.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, sipas vendimeve të KAS-it, për kërkesën ankimore numër 80 për rinumërimin e votave të kutitë e votimit për kryetar për bashkinë Rrogozhinë janë ngritur 6 grupe numërimi, me përbërje si më poshtë:

Grupi i parë i numërimit është: Ardian Losha, Migena Xibinaku;

Grupi i dytë është: Lorena Mavriqi, Sara Gjikhuri;

Grupi i tretë është: Klodiana Nogu, Panajot Shahu;

Grupi i katërt është: Elvis Beja, Ines Mbishahu;

Grupi i pestë është: Elio Ramo, Erida Torollai;

Grupi i gjashtë është: Mariola Hoxha, Arlinda Malaj.

Këto janë 6 grupet që do të numërojnë. Vëzhguesit janë përkrah grupeve të numërimit.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. L. Braho: A i kanë sjellë listat të dy subjektet?

Z. Y. Merko: Të dy subjektet i kanë sjellë listat janë pajisur me beixhet.

Z. L. Braho: Po atëherë, kushti i parë që duhet të plotësojë gjithsecili, sidomos vëzhguesit është që të ruajnë qetësinë gjatë procesit. Për çdo pretendim, që nuk dakordësojnë me grupin e numërimit, që janë administrata e KQZ-së, të ngrenë dorën, dhe do të jetë administrata që do ta vlerësojë. Është një proces që e kemi bërë edhe në vitin 2021, ndaj nuk ka asnjë gjë për t'u alarmuar, dhe për të bërë zhurmë. Kutitë e votimit, pra procesi i numërimit do të kryhet sipas procedurës së përcaktuar në Kodin Zgjedhor, duke filluar nga kutia me numrin më të vogël, dhe në vijim. Administrata e KAZ-së të më sjellë dhe një manual për vlerësimin e votave. Manualin e paskemi. Paskemi dhe udhëzuesin e punës për KZAZ-në. Për pjesën e vulave të sigurisë, vulat e sigurisë të verifikohen vetë nga grupet e numërimit dhe nga vëzhguesit. Nuk është e nevojshme të thuhet me zë të lartë, nëse ka pretendime, të njoftohemi dhe do ta zgjidhim çështjen. Nga ky moment mund të fillojë hapja e kutive për Bashkinë Rrogzhinë. Atëherë, shoh se ka persona që rrinë edhe këtej brenda shiritit. Tani, subjektet zgjedhore kanë vëzhgues, kështu që nuk është nevoja as për sytë e kandidatit, as për ndonjë person tjetër të tretë. Përveç përfaqësuesve të partive, pjesa tjetër, ju lutem, larg grupeve të numërimit!

(Diskutime pa mikrofon)

Dakord. Atëherë, për qendrën e votimit 2207/01 janë kontestuar nga vëzhguesit 5 fletë votimi. KAS-i me vendim vendos që t'i lërë vlerësimet siç janë përcaktuar nga Grupi i Numërimit.

(Diskutime pa mikrofon)

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. F. Nuri: A mund ta di , ju lutem edhe një herë numrin e qendrës së votimit?

Z. L. Braho: 2207/1. Atëherë, janë 3 fletë votimi janë kontestuar për shkak se ka elemente boje në fletët e votimit, por duket që nuk janë elemente të tilla, që të cenojnë vlefshmërinë e votës. 2 fletë votimi, që janë kontestuar, njëra ka një shenjë në formë ylli, kurse tjetra ka të shkruar: po dhe po-ja është e shkruar çuditshëm, pra është grepi nga ana tjetër, por që duket se është shprehur qartë vullneti, kështu që janë fletë të vlefshme. Nga grupi i numërimit 2, janë sjellë dy vota që nga KZAZ-ja ose më saktë nga GNV-të e KZAZ-ve janë konsideruar të pavlefshme, ku ka shenja për të dy kandidatët. Janë për qendrën e votimit 2209/01 dhe të dyja votat do të vazhdojnë të jenë të pavlefshme.

Z. K. Bele: Më falni, një tërheqje vëmendjeje vëzhguesve, kini parasysht ata që janë të qarta mos bëni, për shembull ato dyja që kaluan përpara, secila kishin kryqe të qarta në dy kuti. Mos kontestoni për efekt kontestimi. Jeni njerëz që ju kanë sjellë për një arsye, nuk ka nevojë të jepni prova dhe të harxhoni kohën tuaj dhe kohën tonë.

Z. L. Braho: Grupi i numërimit numër 5 ka sjellë një fletë votimi për qendrën e votimit numër 2198 që ka dy kryqe, një kryq e ka në krahun e djathtë të emrit ku është dhe kutia, një kryq tjetër e ka në krahun e majtë të emrit që bëhet fjalë për të njëjtin kandidat. Fleta është e vlefshme. Atëherë për këtë fletën e votimit që ka ardhur nga qendra e votimit për qendrën 2232, kjo është e vlefshme, siç edhe është vendosur nga GNV-ja.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. F. Nuri: Kam vetëm një sugjerim apo një kërkesë, a mund ta hidhni me votim herë pas here, do të thotë formalisht?

Z. L. Braho: Kur e bëjmë me votim e bëjmë. Për këto që kemi folur deri tani me votim kanë qenë.

Z. F. Nuri: Faleminderit!

Z. L. Braho: Atëherë, janë dy fletë votimi që vula e kryetarit të KQV-së nga pas që është dhe vula me numër nuk duket numri i vulës. Pra, duket që ka pjesërisht vulë, por pjesën e numrit të vulës nuk e nxjerrim dot nga fleta e votimit.

Z. K. Bele: Është ndarë vula përgjysmë.

Z. L. Braho: Mund të afroheni t'i shihni dhe të mbani qëndrim edhe ju.

(Diskutime pa mikrofon)

Ku janë përfaqësuesit e tjerë? Marenglen, a ke ndonjë qëndrim?

Z. M. Legisi: Jo.

Z. L. Braho: Atëherë, për dy votat që u mor dhe mendimi subjekteve zgjedhore, janë të vlefshme edhe për KAS-in për qendrën e votimit 2211. Ndërkohë e njëjta gjë është me një votë të qendrës së votimit 2232, që është konsideruar e vlefshme dhe mbetet e vlefshme edhe pse një nga vulat nuk duket qartësisht, por duket që është vendosur vula.

*Zbardhi materialin/audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. F. Nuri: A mund ta shohim edhe ne?

Z. L. Braho: Mund të afroheni këtu. Atëherë për fletën e votimit në qendrën e votimit numër 2211, ku ka një shkrim te kuadrati që duhet të bëhet shënimi në favor të kandidatit, ka një emër dhe një mbiemër, mund të jetë *nickname*, nuk e dimë këtë, por që për KZAZ-në dhe për GNV-në ka qenë fletë e vlefshme, për KAS-in me shumicë votash është fletë e pavlefshme. 3 fletë votimi në qendrën e votimit 2148 janë fletë të vlefshme. 2 fletë votimi në qendrën 2232...

Z. K. Bele: Janë dy qendra të ndryshme.

Z. L. Braho: Po, njëra është për 2232 dhe ka një shënimin te një nga kandidatët, “je ma i miri”. Këtë fletë GNV-ja e ka konsideruar të vlefshme edhe KAS-i me shumicë votash e konsideron të vlefshme. Fleta tjetër i përkon qendrës 2226, ka një shënim “po” në krah të kandidatit. Ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme. Qendra e votimit 2212, një votë që ka qenë e vlefshme për GNV-në me kryq te numri i kandidatit, është konsideruar e vlefshme, mbetet e vlefshme, sepse është në standardet e përcaktuara dhe nga manuali i miratuar nga KQZ-ja. Atëherë, në qendrën e votimit 2232, përveç kryqit brenda kuadratit, ka edhe një shenjë tjetër në krah dhe jashtë kuadratit. Për GNV-në është e vlefshme, për KAS-in me shumicë votash është e vlefshme. Te qendra e votimit 2210 janë dy fletë votimi që kanë qenë të vlefshme dhe kontestimi bëhet për shkak të vulave të qendrave të votimit, jo të kryetarëve kësaj here, por numri është i identifikueshëm dhe me stadartin e mbajtur dhe më parë, fletët e votimit mbeten të vlefshme. Atëherë, në lidhje me kërkesën ankimore që i takon Bashkisë Elbasan, që është kërkesa ankimore numër 85, për arsye se tashmë ka nisur procesi i këqyrjes të të gjitha kutive të votimit të Bashkisë Belsh

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

dhe meqenëse kërkohet kohë dhe nga administrata e KQZ-së për t'u njohur me pretendimet në lidhje me procesverbalet, që ngriti përfaqësuesi i palës ankimuese, seanca do të riçelet ditën e mërkurë ora 10.30. Palët të jenë gati. Atëherë, seanca për Elbasanin do të caktohet ditën e mërkurë ora 11:00. Atëherë, në fletën e votimit të qendrës 2154 /01 është një fletë votimi që është konsideruar e pavlefshme nga GNV-ja, edhe KASi me shumicë votash e konsideron të pavlefshme. Mungon vula e kryetarit të KQV-së, pra një nga vulat mungon.

Z. V. Gumi: Mungon një vulë, apo jo? Tani, këtu diskutohet e ka manuali, a mund të dimë pikën e manualit që e konsideron të pavlefshme këtë gjë? Sepse vula është pjesë e punës së administratës, nuk është pjesë e votuesit dhe votuesi, nuk mund dhe ka vendim të Kolegjit për të cilin votuesi nuk mund të penalizohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë ftoj KAS-in për të diskutuar tekstin e manualit dhe për ta parë nëse përputhet me ligjin ose jo. Çështja qëndron që ka vendim të Kolegjit Zgjedhor të zgjedhjeve të mëparshme kur e ka cituar që mungesa e vulës është defekt i administratës dhe jo ves i atij që voton. Ai që voton nuk mund të penalizohet për shkak se administrata nuk kreu detyrën siç duhet.

(Diskutime pa mikrofon)

Po, nuk e parë. Po kjo pikë, nuk mund ta vërë fajin te zgjedhësi për një gjë që e ka administrata, zgjedhësi, përkundrazi duhet të ndihmohet për këtë gjë maksimalitetin e interpretimit të tolerancës. Kastile nuk vendoset vula, por zgjedhësit janë, nuk ka profesor doktor që shkojnë aty.

Z. K. Bele: Ka një problem aty, ai manual ka vendosur një standard për të gjithë Shqipërinë me të mirat dhe me të këqijat. Do të ishte shumë e drejtë ta kontestoni.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: *Legaly binding* manual i përkasin. Manuali është udhëzim i Komisionerit për vartësit e tij. KAS-i duhet ta shikojë përputhjen e manualit me Kodin Zgjedhor dhe me vendimet e Kolegjit.

Z. K. Bele: Neni 117 shkronja “b” është: në letrën e votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103.

(Diskutime pa mikrofon)

E paska dhe të cituar. Sigurisht në koncept ti ke të drejtë kur e shtron për diskutim, sepse faktin që një anëtar i administratës nuk e bën detyrën, qoftë edhe për shkak të pakujdesisë, harron të vërë një vulë, është vërtetë të vendosesh në një kryqëzim si të mohosh vullnetin e një zgjedhësi. Nga ana tjetër janë disa *great line* që ti i ke të domosdoshme për procesin. Në këtë rast kjo citohet në ligj, i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103.

Z. V. Gumi: Zoti Koli, procesi që kemi ne është me kaq shumë grait line, sa që ajo vula edhe sikur të mos jetë fare nuk e pengon asnjë gjë. Edhe fleta e votimit është me specifikime si paraja.

Z. K. Bele: Ju keni gjetur këtë teknikë në shkrimin e ligjit, mbase ka nevojë për një ligj më të thjeshtë.

Z. V. Gumi: Po e di si ka ardhur ajo vula, vulë mbivendosjeje, besim mbi besim për besimin dhe kush është vlerësimi i votës.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

(Diskutime pa mikrofon)

Z. E. Lako: Cila qendër votimi është, zoti relator?

Z. L. Braho: 21 54/01.

Z. V. Gumi: Me sa di unë zoti Rusmali është vendim i vjetër i Kolegjit në kohën e kandidatit të ndjerë Sokol Olldashi. Kolegji Zgjedhor e ka marrë në shqyrtim këtë çështje dhe ka thënë se individi, votuesit (se më kujtohet tekstualisht shprehja) nuk mund t'i mbarten defektet e administratës. Kanë qenë fletë votimi të cilat janë dërguar, por kanë qenë në atë formë, sepse janë të tilla që kanë numër serial, kanë elemente sigurie, kanë procedurë, tabelohen në mënyrë e duhur, nuk krijohen probleme te qendra e votimit, pse duhet deklaruar e pavlefshme? Fletës së votimit i mungojnë vulat. Kazusi jonë është që mungon një vulë, pra njëjës, jo shumës.

Z. L. Braho: Neni 117, pika 3 shkronja “b”: Fletës së votimit u mungojnë vulat.

Z. V. Gumi: Vulat, do të thotë kazusi jonë është me një vulë, jo me dy. Përdor numrin njëjës, jo shumës në rastin konkret.

Z. L. Braho: Ky është debati që po bëjmë edhe ne tani.

Z. V. Gumi: Po.

Z. M. Legisi: A mund të them diçka?

*Zbardhi materidlin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. L. Braho: Po, zoti Legisi.

Z. M. Legisi: Nga mënyra si shihet kjo paligjshmëria e fletës së votimit unë e kuptoj që mund t'i ndajmë në dy lloje pavlefshmërie, nga njëra anë e shkakton vetë votuesi ose me qëllim ose pa qëllim, ndërsa pavlefshmëria për të cilën po diskutojmë është për shkak të ligjit. Në këtë kuptim kur i mungon njëra ose të dyja vulat ajo si e tillë duhet të konsiderohet, pra e pavlefshme.

Z. V. Gumi: Kur mungon njëra është interpretim.

Z. M. Legisi: E kuptoj. Për ne kjo është, e kuptojmë se nuk e ka bërë njërën ose të tjetrën, por thotë të dyja, ose më saktë vulat, por kur shkojmë te 103-shi ne kuptojmë se cila është njëra prej vulave.

Z. L. Braho: Atëherë, në lidhje me këtë fletë votimi, deri sa të presim edhe një vendim të Komisionit Rregullator, do ta shtyjmë vlerësimin e saj. Na e lër ne këtu.

Z. F. Nuri: A mund të vijmë t'i shohim edhe ne aty?

Z. L. Braho: Qendra e votimit 2199, votë e vlefshme nga KZAZ-ja e vlefshme dhe nga KAS-i. Në qendrën e votimit 2229 dy vota që kanë qenë të pavlefshme nga GNV-ja për shkak se njëra nga vulat nuk dukej mirë, më konkretisht vula e KQV-së nga të pavlefshme, për KAS-in janë të vlefshme. Me shumicë votash një fletë votimi e qendrës së votimit 2201 ka qenë e vlefshme për KZAZ-në, me shumicë votash mbetet e vlefshme dhe për KAS-in. Atëherë, në qendrën e votimit 2156 janë 6 fletë votimi që janë sjellë për kontestim, një nga këto ka qenë e pavlefshme dhe për në

*Zbardhi materialin/audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 5.06.2023*

kontestim kërkohet të bëhet e vlefshme, KAS-i me shumicë votash vendosi që të vijojë të mbetet e pavlefshme, ndërkohë që për 5 vota të tjera, që janë konsideruar të vlefshme, për një të tretën prej tyre, KAS-i me shumicë votash vendosi që të jetë e vlefshme. Pra, me shumicë votash është vendosur për dy vota sipas vendimmarrjes së GNV-së. Në qendrën e votimit 2199 një fletë votimi ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme. Atëherë, për fletën e votimit që ishte pa vulën e kryetarit të KQV-së KAS-i me shumicë votash lë në fuqi vendimin e GNV-së që të jetë fletë votimi e pavlefshme. Te qendra e votimit 2156 për një votë që ka dy shënime, te një nga kandidatët ka një vizë dhe te kandidati tjetër kryq, që ka qenë e pavlefshme, KAS-i me shumicë votash vendosi që ta lërë si votë të pavlefshme.

Z. K. Bele: Ky është rast i përsëritur si tipologji për QV-në 2225. Është një fletë e konsideruar e vlefshme nga grupi edhe KAS-i, gjithashtu, e konsideron të vlefshme. Për qendrën e votimit 2203/1 kjo fletë është e vlefshme, një fletë votimi e konsideruar e vlefshme mbetet po e vlefshme dhe fleta e dytë e votimit e konsideruar e vlefshme, me shumicë votash mbetet e vlefshme. Për qendrën e votimit 2203/1 është një fletë votimi e konsideruar e vlefshme nga GNV-ja, KAS-i me shumicë e konsideron të pavlefshme.

Z. L. Braho: Në qendrën e votimit 2208/1, janë sjellë për kontestim 7 fletë votimi, që janë konsideruar të shtata të vlefshme. Mbeten të shtata të vlefshme.

Z. F. Nuri: Ndjesë!

Z. V. Gumi: T'i rikthehem vlerësimit të mëparshëm, që ishte fleta e votimit me shënimin "je ma i miri". Meqenëse po e shikojmë çështjen me një vulë ose dy vula

*Zbardhi materialin/audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

është vendim i Rregullatorit, një fjali më poshtë thotë Rregullatori: Votë e pavlefshme është edhe kur në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit. “Je ma i miri” është në favor të kandidatit.

Z. L. Braho: Zoti Gumi, ne që dolëm pakicë me këtë qëndrim se e ka dhe Kodi Zgjedhor të 117-ta, pavarësisht udhëzuesit e ka Kodi, që është në favor dhe kjo ishte arsyeja pse dolëm pakicë.

Z. V. Gumi: Jo, kjo fletë votimi mbi bazën e këtij manuali, që ne na dolën të pavlefshme fletë votimi me një kuti, a duhet të konsiderohet? Sepse ky manual thotë se kur bëhet shënime në favor të kandidatit, vota është e pavlefshme. Kur bën shënime në disfavor të kandidatit, vota është e pavlefshme. Zemra në krah të kutisë së votimit është favor.

Z. L. Braho: Edhe te zemra po të njëjtin qëndrim.

Z.V. Gumi: A do t’i vlerësojmë këto fletë votimi, sepse manuali e thotë qartë.

Z. L. Braho: Atëherë në qendrën e votimit 2227/01 për një fletë votimi që ka qenë e pavlefshme nga KZAZ-ja, për KAS-in me shumicë votash konsiderohet e vlefshme. Në qendrën e votimit 2208/1 janë 4 vota që janë konsideruar të pavlefshme për grupet e numërimit në KZAZ, edhe KAS-i me shumicë votash vendos t’i quajë të pavlefshme. Fletët e votimit të qendrës 2208/1 për GNV-në kanë qenë fletë votimi të vlefshme, për KAS-in janë të vlefshme me përjashtim të njëjës që është me shumicë votash e vlefshme. Për qendrën e votimit 2208 një fletë votimi

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme. Për fletën e votimit të qendrës së votimit 2200/1 që ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme. Për qendrën e votimit 2197/1 një votë që ka qenë e pavlefshme, me vendim të KAS-it bëhet e vlefshme.

Z. F. Nuri: Cila qendër votimi ishte?

Z. V. Gumi: Zoti Ledio, dikush nga vëzhguesit thotë që ka ardhur kutia e IEPV-së Rrogozhinë. Pra, ka ardhur radhë për t'u hapur kutia e burgut të Rrogozhinës. Të hapet në vijimësi apo të hapet në fund fare?

Z. L. Braho: Të hapet sipas radhës. Në qendrën e votimit 2227/1 dy vota që janë vlerësuar të vlefshme nga GNV-të, janë të vlefshme edhe për KAS-in. Në qendrën e votimit 2224/01 një votë që ka qenë e vlefshme për GNV-në, me shumicë votash është e vlefshme dhe për KAS-in. Në qendrën e votimit 2213 një fletë votimi ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme dhe për KAS-in. Në qendrën e votimit 2200 dy fletë votimi që kanë qenë të vlefshme për GNV-në, janë të vlefshme dhe për KAS-in. Në qendrën e votimit 2153 një fletë votimi ka qenë e vlefshme për GNV-në, është e vlefshme edhe për KAS-in.

(Diskutime pa mikrofon)

Në qendrën e votimit 2153 një fletë votimi, që i mungon vula e kryetarit të KZV-së, ka qenë e pavlefshme, me shumicë votash dhe për KAS-in është e pavlefshme. Në qendrën e votimit 2227, pesë fletë votimi, që kanë qenë të vlefshme, vijojnë janë të vlefshme. Shpjegoja pak edhe vëzhguesve këtë. Në qendrën e votimit 2150/1 janë dy fletë votimi që kanë qenë të vlefshme, me shumicë votash vijojnë të jenë të vlefshme. Një fletë votimi në qendrën e votimit numër 2149 ka qenë e vlefshme mbetet e vlefshme. Në qendrën e votimit 2197 është një fletë votimi që ka qenë e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

pavlefshme, nuk ka asnjë nga vultat pas fletës së votimit. A ka ndonjë diskutim nga palët meqenëse u diskutua me një vulë, kur nuk ka asnjë vulë?

Z. V. Gumi: Unë them për t'i qëndruar strikt asaj që parashikon ligji, ligji përmend numrin shumë, pra, mungojnë vultat. Nëse është çështje e diskrecionit për ta zbatuar ose jo, ligji e ka përcaktuar në shumë "mungojnë vultat". Kjo do të thotë që ajo fletë votimi është e pavlefshme në interpretimin tim. Në qoftë se kemi të bëjmë me një vulë, çdo lloj interpretimi është i kundërt, sepse edhe ligji, edhe manuali duhet të nxirrite, nuk ka dy vultat ose të paktën një vulë. Por për sa kohë ligji thotë: nuk ka dy vultat, atëherë unë nuk kam si të dalë.

Z. L. Braho: Kjo fletë votimi vazhdon të mbetet e pavlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2151 dy fletë votimi që kanë qenë të vlefshme, mbeten të vlefshme edhe për KAS-in. Atëherë një fletë votimi në qendrën e votimit nr. 2151 ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme me shumicë votash; në qendrën e votimit nr. 2233 ka qenë një votë e vlefshme, mbetet e vlefshme; në qendrën e votimit nr. 2207, dy fletë votimi që kanë qenë të pavlefshme, njëra prej tyre bëhet e vlefshme. Kjo, që ta shohin. Në qendrën e votimit nr. 2197 një fletë votimi që ishte e vlefshme, mbetet e vlefshme. Dy fletë votimi që ishin të pavlefshme, me shumicë votash mbeten të pavlefshme. QV-ja nr. 2233. Në qendrën e votimit nr. 2228/1, 3 vota që kanë qenë të vlefshme, edhe për KAS-in janë të vlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2228/1 një fletë votimi që ka qenë e pavlefshme mbetet e pavlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2228 një fletë votimi ka qenë e pavlefshme, mbetet e pavlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2224 një fletë votimi ka qenë e pavlefshme, vijon të mbetet e pavlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2228/01 një fletë votimi që ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme; po në këtë qendër votimi 4 fletë të tjera që kanë qenë të vlefshme, mbeten

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

të vlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2229/01 një fletë votimi që ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2150 një fletë votimi ka qenë e vlefshme, mbetet e vlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2214 një votë është e vlefshme për GNV-në, edhe për KAS-in me shumicë votash është e vlefshme. Në qendrën e votimit nr. 2224 janë dy fletë votimi që kanë qenë e vlefshme dhe mbeten të vlefshme, njëra prej tyre me shumicë votash. Ylli, të të bëjmë një pyetje: me këto fletët e hedhura gabim, në qoftë se gjatë numërimit të fletëve në këshill janë gjetur dy vota për kandidatin për kryetar, pavarësisht në favor të kujt, si ka funksionuar kur ka qenë dy fletë të hedhura gabim, janë përlllogaritur te rezultati i kryetarit?

Z. Y. Merkaj: Kutia e fletëve të hedhura gabim numërohet në fund të numërimit. Mbarojnë të gjitha kutitë dhe numërohen. Rezultati që del nga kjo tabelë i bashkohet rezultatit përfundimtar.

Z. L. Braho: Pra, ka një tabelë vetëm me fletët e hedhura gabim?

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. L. Braho: E kemi ne këtë tabelën.

Z. Y. Merkaj: Po.

Z. L. Braho: Po, zoti Gumi.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: Tek tabela e miratimit që ka bërë kryetari i KQZ-së ka çdo qendër votimi dhe në çdo qendër votimi është numri i fletëve të hedhura gabim. Për shembull, për qendrën e votimit nr. 2200 ka zero fletë votimi; për qendrën e votimit 2200/1 ka një fletë të hedhur gabim. Tabela e rezultatit i ka tabeluar edhe qendrat e votimit me fletë të hedhura gabim.

Z. I. Rusmali: Ne kemi nevojë që të dëgjojmë të dyja palët për këtë rast. Ky rast konfirmon nga tabela e rezultateve për këshillin, që janë dy vota të hedhura gabim, ndërkohë që në numërim mungojnë dy vota nga kutia e kandidatëve për kryetar bashkie. Nga ana tjetër, në tabelën e rezultateve për kryetar bashkie i janë vënë 2 vota plus kandidatit të Partisë Socialiste. Alternativat që kemi ne tani, ju të dy palët e konfirmoni si fakt të mirëqenë këtë dhe kërkoni që ne t'ia shtojmë, pavarësisht se nuk ndodhen, apo doni që ne të hapim kutinë tjetër dhe t'i administrojmë ato dy vota dhe t'i hedhim në kutinë e saktë? Cili është qëndrimi ligjor juaji?

Z. V. Gumi: Në qoftë se ju kuptova gabim, ju keni parë të njëjtën qendër votimi edhe për këshillin dhe ju rezulton që janë dy vota plus? Unë po flas në emër të kandidatit dhe jo të subjektit. Ne kemi ardhur në këtë seancë gjyqësore për transparencën, për të numëruar çdo kuti, kjo do të thotë që ne kërkojmë që të administrohet vota e këshillit, të hapet, të shikohet dhe verifikohet nëse ky fakt qëndron ose jo.

Z. I. Rusmali: Ok. Do të thotë jo administrohet vota e këshillit, të administrohet kutia, të nxirren dy votat e hedhura gabim dhe të administrohen ato.

Z. V. Gumi: Më falni, ndoshta duhet të shikojmë integritetin në tërësi të votës së këshillit, sepse, nëse futemi te kutia e këshillit dhe gjejmë zarfën me këto dy votat e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

hedhura gabim, besoj është vendi për të parë edhe integritetin e kutisë në tërësi, sepse mund të rregullojmë dyshen, por mund të prishim një tabelë tjetër.

Z. I. Rusmali: Pse mendon që në atë kuti do të jenë vetëm këto dy vota?

Z. V. Gumi: Unë nuk e di se çfarë do të ndodhë. Unë di këtë që nga tabela rezulton kjo gjë, kur ta shikojmë në situatë të caktuar...

Z. I. Rusmali: Nga tabela rezultojnë të gjitha votat për këshillin plus shënimi në rubrikën e posaçme, “fletë të hedhura gabim 2 copë”.

Z. V. Gumi: Prandaj po them, duhet të shikojmë integritetin e të gjithë kutisë.

Z. I. Rusmali: Pse ke dyshime për integritetin e kutisë?

Z. V. Gumi: Sepse ka ndodhur. Fakti që po e rinumërojmë...

Z. I. Rusmali: Ka ndodhur në këtë rast?

Z. V. Gumi: Besojmë se mund të ketë ndodhur.

Z. I. Rusmali: Praktika burokratike në këtë rast është ekselente. Dy vota të hedhura gabim janë shënuar që janë hedhur gabim, janë shënuar. Ka dyshime për faktin që ekzistojnë ato dy vota apo jo?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: Këto dy vota ekzistojnë. Problemi qëndron që integriteti i këtyre dy votave vjen si pasojë e integritetit të kutisë.

Z. I. Rusmali: Do të thotë do të kontrollosh vulat e ...

Z. V. Gumi: Ne kërkojmë të kontrollojmë të gjithë kutinë e këshillit.

Z. I. Rusmali: Çfarë do të gjesh?

Z. V. Gumi: Sepse kutia e këshillit për votat e këshillit mund të dalë me minus 5, gjë që do të thotë që ky integritet është i cenueshëm, sepse jemi në një fazë me këtë, por ndërkohë jemi në një fazë tjetër me minus 5, minus 7 apo minus 10. Kjo do të thotë që ne duhet t'i qëndrojmë integritetit. Integriteti i këshillit nuk janë vetëm 2 votat, integritetin e kutisë.

Z. L. Braho: Zoti Gumi, në qoftë se mund të sqaroj diçka. Tani nga pajisja PEI rezulton se në këtë qendër votimi kanë votuar 247 persona. Nga kutia që sapo u hap për kryetar këshilli rezultuan 245 fletë votimi, pra dy më pak sesa votues, ndërkohë që te kutia e këshillit nga procesverbali gjithmonë, se kutia nuk është hapur, rezulton të jenë gjetur 249 fletë, pra dy fletë më shumë sesa numri i votuesve, çka matematikisht e bën të qartë që janë dy fletë më tepër, numri i votuesve është i njëjtë. A mendon ti se ky rezultat, kur përputhet në këtë mënyrë dhe ne në qoftë se i gjejmë ato dy fletë që janë fletë për kryetarin e bashkisë në kutinë e këshillit, mendon që cenon këshillin apo integritetin e kutisë kur çdo gjë përputhet? Pra, duhet të hapim ne edhe fletët për këshillin bashkiak?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: Unë mendoj, i nderuar, zoti Ledio, që ne kemi ardhur këtu e po diskutojmë edhe një votë teke të vlefshme. Apo jo? Ne duhet të shikojmë integritetin, për mendimin tim, edhe të atij këshilli. Nuk duhet ta marrim apriori një fletë votimi që gjendet në atë mënyrë dhe ta transpozojmë në një rezultat. Mund të ndodhë që ajo kuti me ato rezultate, PEI mund të dalë minus 10 vota tek votimi për këshillin, si do të veprojmë? Ne po marrim një integritet për ta futur në këtë proces transparence. Ta mbyllim transparencën e asaj kutie në 100%, pse duhet të marrim një element të saj.

Z. L. Braho: Ylli, i kemi kutitë e këshillave ne këtu? Nuk janë? Nga informacioni që keni ju, ka qendra të tjera që kanë pasur fletë të hedhura gabim?

Z. Y. Merkaj: Kemi vetëm dy kuti të fundit.

Z. L. Braho: Të silllet kutia, do të vendosim më tej nëse do të këqyrim vetëm këto dy fletë apo të gjithë kutinë.

Z. E. Saliq: Meqenëse vendosët për të sjellë kutinë e do ta hetoni këtë rast, atëherë kjo do të hetohet bashkë me kutinë e materialeve zgjedhore, që aty të verifikohet sa kanë votuar. Unë do të isha me logjikën aritmetike...

Z. I. Rusmali: Më fal që po ndërhyj, ky është dokument zyrtar, i cili nuk ka motiv të hidhet poshtë sa kohë nuk ka një pretendim, një provë, një dokument tjetër që ta kundërshtojë këtë. Ky dokument zyrtar thotë që në këtë kuti kam dy vota plus që i përkasin kandidatit. Këtë thotë dokumenti zyrtar. Sheh Viktori ëndrra dhe i duket që

*Zbardhi materialet audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

në atë kuti duhet të jetë bërë nami. Tani po shikon ti ëndrra që duket sikur në kutinë tjetër ...

Z. E. Salianji: Unë jam për aritmetikën. Unë jam që ju ta kishit mbyllur tabelën e grupit të numërimit.

Z. I. Rusmali: Aritmetika mbyllet me këtë dokument.

Z. E. Salianji: Po ta mbyllni këtu.

Z. I. Rusmali: Ne nuk do mbyllim qendrën, do të administrojmë 2 votat, do i çojmë në kutinë e saktë dhe pastaj do e mbyllim. Për çfarë duhen kërkesat e tjera?

Z. E. Salianji: Edhe një herë, ju e vërtetuat aritmetikisht që ekziston aritmetika që duhet të rrijë numri që është në tabelën e grupit të numërimit, për arsye se u gjetën ku janë ato dy fletë. Meqenëse ju vendosët që ta thellonit hetimin, që të bëni një hetim më të plotë, merrni edhe kutinë e materialeve zgjedhore dhe shikoni sa kanë votuar. Unë isha me variantin e parë. Tani vazhdon ëndrra?

Z. I. Rusmali: Nuk ka dyshime për sa kanë votuar. Nuk ka asnjë dyshim sa veta kanë votuar. Shifra rakordon në të gjitha letrat e komisionit. Nuk dyshime. E ngre ti Viktor këtë? E ngre ti që ka dyshime sa veta kanë votuar?

V. Gumi: Ne në pretendimet tona ...

Z. I. Rusmali: Të lutem shumë, mos na...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: Ne e kemi ngritur këtë. Në listën e qendrave të votimit...

Z. I. Rusmali: Të lutem shumë, në këtë qendër votimi, 247 votues sipas librave, 249 vota në këshill, 245 këtu. Ka dyshime për numrin e votuesve në këtë qendër votimi? Mos bëni kështu, se është abuzim me procedurën.

Z. V. Gumi: Të nderuar anëtarë të KAS-it, ne erdhëm për rinumërim. Ne po diskutojmë me orë të tëra këtu edhe një fletë të vetme votimi. Të transpozojmë dy fletë votimi pa verifikuar edhe integritetin e asaj kutie...

Z. I. Rusmali: Po diskutojmë ka apo nuk ka dyshim për numrin e zgjedhësve.

Z. V. Gumi: Kemi dyshime.

Z. I. Rusmali: Ku i bazon dyshimet? Në ç' dokument të kësaj qendre votimi bazohen dyshimet për numrin e zgjedhësve për këtë qendër votimi,

Z. V. Gumi: Po, po për këtë qendër votimi jua kemi sjellë me listën e dokumentacionit, pasi kemi verifikuar tabelat, keni shënimin për këtë qendër votimi, kandidatit i janë shtuar dy vota, dhe e kemi shënuar për këtë qendër votimi. Nuk po them për qendrën e këshillit, por këtë qendër e kemi evidentuar ne dhe ia kemi thënë me shkrim.

Z. I. Rusmali: Kandidatit i janë shtuar 2 vota...

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. V. Gumi: Vota e grupit të numërimit me...

Z. I. Rusmali: Vota e këshillit tregon që janë dy vota plus në kutinë e këshillit. Po t'i heqim aty, bëhen barabar. Numri sipas kalkulimit, numri sipas kutisë 1, numri sipas kutisë 2. Çfarë diskutimi keni për numrin e zgjedhësve? Nuk po diskutoj votat. Për numrin e zgjedhësve çfarë diskutimi keni?

Z. Sh. Hoxha: Më falni, nëse më lejohet, janë dy vota që janë hedhur gabim, janë edhe dy vota që i janë shtuar PS-së. E ka tabela. Ka dy vota plus për PS-në.

Z. I. Rusmali: Procedura, Ylli, është e rreptë te votat e hedhura gabim dhe duhet të jetë edhe e qartë për KZAZ-në, apo jo. Votat e hedhura gabim nuk kalkuloohen, hidhen në kutinë e saktë dhe kalkuloohen. Pse nuk ka ndodhur kjo aty?

Z. L. Braho: Në qendrën e votimit nr. 2150 4 fletë votimi kanë qenë të vlefshme, mbeten të vlefshme. Atëherë, pasi e zgjidhëm proceduralisht çështjen e votave të hedhura gabim, nuk është më e nevojshme që të sillet kutia e këshillit për atë qendër votimi, sepse fletët e hedhura gabim janë të gjitha në një kuti të posaçme, që është mbushur në momentin që janë gjetur fletë të hedhura gabim. Mbaroi numërimi për të gjitha? Janë bërë gati të gjitha procesverbalet dhe tabela përmbledhëse? E ndërpresim disa minuta seancën sa të sqarohemi për rezultatin dhe mbledhemi sërish.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Rifillon seanca

Ora 18.10

Z. L. Braho: Meqenëse procesi i numërimit, i vlerësimit mbaroi, vëzhguesit janë të lirë të largohen dhe të pranishëm në sallë të jenë kandidatët, përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore. Pjesa tjetër nuk është më e nevojshme, e kanë kryer me sukses detyrën. I falënderojmë.

Riçelim seancën për shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 80 me ankues koalicionin “Bashkë Fitojmë” për tabelën e rezultateve të Bashkisë Rrogozhinë. Pasi u rivlerësuan dhe u rinumëruan votat, si të vlefshmet dhe të pavlefshmet, për të 55 qendrat e votimit që i përkasin Bashkisë Rrogozhinë, miratohet me vendim të ndërmjetëm tabela përmbledhëse e rezultateve sipas rivlerësimit që iu bë në KQZ në seancë shqyrtimi nga KAS. Në lidhje me votat, vota të vlefshme janë gjetur gjithsej 10237, vota të pavlefshme 273, vota për kandidatin Edison Memolla 5129, vota për kandidatin Shkëlqim Hoxha 5108. Pjesa tjetër e tabelës do të jetë bashkëlidhur vendimit të KAS-it, por ky është rezultati për sa i përket kësaj faze të hetimit administrativ. Në qoftë se nuk ka asnjë pretendim nga palët, vijojmë me pjesën tjetër të shqyrtimit administrativ, që ka të bëjë me kërkime të tjera nga pala ankimuese. Fjala për përfaqësuesin e subjektit ankimues.

Z. V. Gumi: Mund ta marr unë si përfaqësues i personit të tretë? Ju falënderoj. I nderuar zoti drejtues i seancës, sikurse e kemi lënë diskutimin për pjesën e mbetur të kërkesës së paraqitur nga personi i tretë dhe nga subjekti zgjedhor, ne dëshirojmë të sjellim në vëmendje të KQZ-së nenin 43 të Kodit Zgjedhor që thotë: “KZAZ-ja, në përputhje me këtë Kod dhe me udhëzimet e KQZ-së, i propozon KQZ-së krijimin

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

e KQV-ve të posaçme në institucionet e posaçme. Këto komisione kanë të njëjtën përbërje dhe të njëjtat përgjegjësi si edhe KQV-ja.” Në zgjedhjet e pjesshme të vitit 2022 është një vendim i datës 4 mars nr. 125 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në bazë të së cilës Komisioni i Zonës të Administrimit Zgjedhor nr. 43 Bashkia Rrogozhinë, me shkresën nr. 1495 prot. datë 3.3.2022 “Propozim për krijimin e KQV-ve të posaçme”, i propozon KQZ-së krijimin e komisionit të qendrës së posaçme të votimit nr. 22241. Ky është vendimi i shfaqur në *ëbsite*-n e KQZ-së. Gjithashtu, përpos këtij vendimi, ekziston edhe një autorizim i sekretarit të Përgjithshëm me nr. 1563, ku ka modalitetet sesi krijohet kjo qendër votimit. Për zgjedhjet e 14 majit 2023 ne kemi konsultuar dhe pyetur përfaqësuesin e KZAZ-së, librin e protokollit të KZAZ-së dhe nuk na rezulton që, së pari, KZAZ-ja t’i jetë drejtuar me shkresë zyrtare Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e kësaj qendre të posaçme. Neni 43 përcakton kompetencën propozuese dhe kompetencën miratuese për këtë gjë. Dëshirojmë të dimë si është krijuar Komisioni i Qendrës së Votimit në IEPV-në Rrogozhinë. Shkresat që kemi pasur deri më sot kanë qenë dërgim dokumentacioni, jo vendimmarrje për krijimin e qendrës së votimit. Shembulli i vitit 2022 është i qartë dhe është i plotë në zbatim të nenit 43 të Kodit Zgjedhor. Institucionet e posaçme janë vendet e paraburgimit, vendet e vuajtjes së dënimit dhe institucionet të tjera shëndetësore për një periudhë më të gjatë se treditore. Si është krijuar kjo qendër votimi? Cili është akti administrativ që e ka krijuar këtë qendër votimi dhe për pasojë mbi bazën e këtij krijimi janë zhvilluar zgjedhjet. Kjo është pyetje për administratën.

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Gumi! Fjala është për sekretarin e Përgjithshëm. Keni pyetje shtesë?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. E. Saliarji: Prapësoj pse pyetja duhet t'i bashkëngjitet pyetjes, duke sqaruar edhe bazën ligjore, pra të bëjmë pyetjen, por të dimë ku ta kërkojmë. Për sa i përket krijimit të qendrës së votimit, neni 62, "Caktimi i zonave dhe vendndodhjes së qendrave të votimit", paragrafi i dytë thotë: "Institucionet e posaçme përbëjnë zonë të veçantë qendre votimi. Qendra e votimit në këto institucione ngrihet kur në to ndodhen mbi 15 zgjedhës". Në këtë qendër votimi është vërtetuar që janë 118 zgjedhës. Pika 4 e nenit 62 thotë: "Vendndodhja e qendrës së votimit caktohet në të njëjtën adresë me atë të zgjedhjeve të fundit..." Pra, adresa në të cilën është caktuar kjo qendër votimi, siç u provua edhe nga pyetja e kolegut është caktuar në atë të zgjedhjeve të fundit, zgjedhjet e vitit 2022, "...kur kjo nuk është e mundur, vendndodhja e qendrës së votimit nuk mund të ndryshojë në 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve". Pika 5: "Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, jo më vonë se afati i përcaktuar në pikën 4 të nenit 51 të këtij Kodi, cakton dhe shpall vendndodhjen e qendrës së votimit në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni.". Shkojmë te nenin 51, "Publikimi i ekstraktit të përbërësve zgjedhorë", pika 4: "Jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve, zyrat e gjendjes civile, pas miratimit nga kryetari i njësisë vendore, printojnë dhe publikojnë ekstraktin e përbërësve zgjedhorë të të gjithë shtetasve që kanë vendbanim në zonat e qendrave të votimit nën juridiksionin e çdo zyre. Publikimi bëhet në zyrat e gjendjes civile.". Shkresa që është depozituar është një listë që i është dërguar KQZ-së me 118 emra, pra pasi drejtori i burgut ka bërë me dije që këta janë 118 që kanë të drejtë të votojnë, në bazë të kësaj liste, gjendja civile ka bërë publikimin e tyre.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. L. Braho: Të bëj një pyetje, zoti Salianji, meqenëse shkove këtu. Dispozita që sapo lexuat ju thoshte “jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi”. Ndërkohë që kjo shkresa që kryetari i Bashkisë Rrogozhinë i ka përcjellë KQZ-së është më 31 mars 2023.

Z. E. Salianji: Ke edhe më përpara praktika.

Z. L. Braho: Është 5-6 muaj pas datës së dekretimit. Ne po themi për këtë që na ka ardhur si provë, nuk e di çfarë shkresash janë bërë më parë.

Z. E. Salianji: Në zgjedhjet e vitit 2022 është caktuar vendndodhja e kësaj qendre votimi dhe kjo ishte edhe adresa. Te përbërësit zgjedhorë thotë që qendrën e votimit e ngre kryetari, prandaj e lexova, nuk e lexova të shkëputur vetëm te KZAZ-ja. KZAZ-ja vepron si te rasti i Belshit, kur nuk ngrihet qendra e votimit, ndërhyr KZAZ-ja, ngre qendra votimi. Në këtë rast është proces rutinë, është bërë procesi që në fillim për identifikimin e zgjedhësve, që kanë pasur të drejtë të votojnë në burgje, është bërë njoftimi në KQZ dhe kjo qendër votimi është numërtuar me vendim KQZ-je. Numërtimi i qendrave të votimit bëhet nga KQZ-ja, të na japë një përgjigje administrata, por nuk mundet asnjë qendër votimi të kalojë pa vendim.

Z. L. Braho: Këtu është gjithë debati. Ankuesi pretendon që nuk ka vendim, ju referoni te kjo e kryetarit të bashkisë, por tani kryetari i bashkisë ka lidhje me adresën si e kuptoj unë dhe adresa e një qendre votimi në IEVP-në e burgut nuk mund të jetë tjetërkund, përveçse në burg, nuk besoj se mund të bëhet diku tjetër, ndaj lidhet me nenin 43 dhe jo me nenin 62. Megjithatë, sekretari i Përgjithshëm mund të na e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 5.06.2023*

sqarojë këtë çështjen e vendimmarrjes së KQZ-së si është numërtuar kjo qendër votimi.

Z. Y. Merkaj: Vendbanimi i qendrës së votimit propozohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore në bazë të nenit 62, pika 5 e Kodit Zgjedhor. Për numërtimin është bërë një sistem unik i numërtimit që merren fraksionet. Besoj se kemi ndjekur të njëjtën praktikë si në vitin 2022. Ne i jemi referuar shkresës së kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë 7.3.2023 në të cilën thotë: propozoj për krijimin e qendrës së votimit të posaçme.

Z. L. Braho: Po, Ylli, po bëjmë të njëjtin debat, se bëre të njëjtën mbrojtje ose të njëjtin prapësim siç e bëri përfaqësuesi i Partisë Socialiste. Pika 5...

Z. Y. Merkaj: Kam interpretuar Kodin.

Z. L. Braho: Pika 5 që referon ti e nenit 62, referon për afat te pika 4 e nenit 51. Pika 4 e nenit 51 thotë “jo më vonë se 30 ditë nga dekretimi i datës së zgjedhjeve”, që duhet të jetë diku nga tetori, nëntori. Kjo dispozitë shërben edhe për këtë.

Z. K. Bele: Kjo është për zgjedhësit, nuk është për qendrën e votimit.

Z. L. Braho: Këtë referon për afat. Ne po themi pse kjo shkresa e kryetarit të bashkisë është më 31 mars, nuk ka të bëjë me vendndodhjen e qendrës, por ka të bëjë me krijimin e një qendre të posaçme, e ka krijuar kryetari i bashkisë.

Z. Y. Merkaj: Kryetari i bashkisë e cakton vendndodhjen e qendrës.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. L. Braho: Po neni 43 i Kodit Zgjedhor çfarë do të thotë?

Z. Y. Merkaj: Neni 43 i Kodit Zgjedhor ka të bëjë vetëm me emërimin e anëtarëve të qendrës së votimit. KZAZ-ja është përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në zonën e administrimit zgjedhor dhe kërkon vetëm emrat e anëtarëve të qendrës së votimit, nuk kërkon vendndodhjen, do emrat e anëtarëve, është qendër e posaçme.

Z. L. Braho: Thotë “krijimin e KQV-ve”, nuk thotë emërimin e anëtarëve.

Z. Y. Merkaj: Krijimin e Komisionit të Qendrës së Votimit, jo të qendrës së votimit, anëtarëve të qendrës së votimit, të komisionit. Ajo do emrat e anëtarëve që t’ua dërgojë partive...

Z. L. Braho: Emrat e anëtarëve i ka emëruar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve?

Z. Y. Merkaj: Jo, pra, si i ka emëruar, thotë kërkoj emrat e anëtarë t’ua propozoj partive apo jo për anëtarë të Komisionit të Qendrës së Votimit. Ka të bëjë vetëm me komisionin, jo me vendndodhjen e qendrës së votimit.

Z. L. Braho: I propozon KQZ-së...

Z. Y. Merkaj: Komisionit pra, anëtarët, 7 anëtarët.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. K. Bele: Tani, më fal, se po konfuzohemi, po kërkojmë QV-në apo komisionin, se Ylli është i paanshëm dhe doli i drejtë ku duhet. Ne te 43-shi po flasim për komisionin e qendrës së votimit, në një kohë që, nëse e kuptuam drejt, ju po merreshit me momentin e krijimit të qendrës së votimit.

Z. V. Gumi: Ne po themi pse nuk është zbatuar praktika e marsit të 2022-it.

Z. K. Bele: Nuk e dimë sa relevante është ajo po..

Z. V. Gumi: Nga websait-i i KQZ-së; është i njëjti problem, është për të njëjtën bashki, po ta përsërisim gabimin.

Z. I. Rusmali: Po pse ta përsërisim gabimin?

Z. V. Gumi: Përderisa është kështu, s'e ka kundërshtuar njeri ligjshmërinë e kësaj.

Z. I. Rusmali: Po s'kemi precedentë, s'kemi pasur.

Z. V. Gumi: Kam unë praktikat. Ka propozim nga KZAZ-ja? Se kjo është pyetja.

Z. Y. Merkaj: KZAZ-ja bën propozim vetëm dhe kërkon emrat e anëtarëve të komisionit, jo qendrën e votimit. Nuk e propozon KZAZ-ja qendrën e votimit.

Z. L. Braho: Po këta anëtarët i ka propozuar KZAZ-ja këtu në KQZ? I ka sjellë emrat e anëtarëve këtu? Dakord, i rrimë kësaj linjës që ju thoni.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. Y. Merkaj: KZAZ-ja iu drejton partive politike, që kanë të drejtë të propozojnë anëtarët në komisionin e qendrës së votimit, emrat për të plotësuar qendrën e votimit.

Z. V. Gumi: Po KZAZ –ja i propozon KQZ-së.

Z. L. Braho: I propozon KQZ-së, Ylli.

Z. Y. Merkaj: Krijimin e komisionit pra, është ngritur qendra e votimit dhe do të jetë kjo qendër votimi, të ketë komision me 7 anëtarë.

Z. L. Braho: Ç'hyn KQZ –ja këtu? KQZ ç'hyn, se sipas dispozitës hyn KQZ-ja te kjo që thoni ju, nuk hyn KQZ –ja se për të vendosur emrat nuk duhen Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mjafton KZAZ-ja me partitë politike dhe u plotësua komisioni, ndërkohë 43 flet për rol KQZ-je këtu.

Z. Y. Merkaj: Këto komisione thotë, kanë të njëjtën përbërje, të njëjtët përzgjedhje si Komisioni i Qendrës së Votimit.

Z. L. Braho: Po, zoti Rusmali.

Z. I. Rusmali: Unë kam një pyetje edhe për Viktorin, edhe për Redianin, edhe për Francin, ndoshta. Komisioni i Qendrës së Votimit te Burgu i Rrogozhinës është ngritur me bashkëpunimin e subjekteve që janë palë në këtë proces ankimor. Ju keni praktikën e ngritjes së këtij komisioni, e dispononi, mund të na e vini neve në dispozicion që ta kuptojmë edhe ne si e keni ngritur këtë komision juve, se jeni palë tek ai komision.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKALJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. E. Saliانji: Të sqaroj në lidhje me pyetjen. Pra, të gjithë konfuzionin e jep neni 43. Po ta lexojmë Kodin, kreu 3 fillon nga neni 36 deri në nenin 43. Lexojmë titullin e kreut 3. Komisioni Qendrës së Votimit ku thotë: neni 36 “Përmbajtja e KQV-së”, neni 37 “Papajtueshmëritë e KQV-së”, neni 38 “Kushtet për emërimin”, neni 39 “Shkarkim, lirim të anëtarit”, neni 40 “Detyrat e KQV-së”, neni 41 “Detyrat e sekretarit të KQV-së”, neni 42 “Mbledhja e vendimeve të KQV-së”, neni 43 “Përbërja dhe përgjegjësitë e KQV-së posaçme”. Pra, po të lexohet se jemi, këtu thotë vetëm përbërja e KQV –së, në përbërje si anëtarë dhe komisione dhe detyrat, nuk flet në asnjë vend ku kre për mënyrën e ngritjes. Pra, arsyetimi që dha sekretari i Përgjithshëm, po të lexohet edhe të interpretohet atë çka vetë kreu 3, që flet për qendrën e votimit, flet për mënyrën e funksionimit të komisionit dhe në fund të dispozitës thotë që përbërja e KQV-së së posaçme, pra, ngrihet edhe një KQV e posaçme me komisione, jo ngritja për vendndodhje, ngritja për vendndodhje janë neni 63, ato që unë lexova në fillim.

Z. I. Rusmali: Pyetja ime ishte shumë e thjeshtë, ne e kuptojmë që ka një lloj konfondimi midis qendrës së votimit dhe komisionit të qendrës së votimit, ne do vrasim mendjen ta çkokolepsim këtë punë, po kjo është histori tjetër. Si është ngritur ky komision praktikë, kjo ka ndodhur apo jo? Kandidati na e shpjegon dot si e ngriti, se kanë çuar emrat këta atje. Kush u tha atyre na sillni emra? Ua thanë me shkrim, ua thanë me gojë apo ua tha përfaqësuesi i tyre, këtë gjë praktike, a na i shpjegoni dot?

Z. V. Gumi: Në lidhje me këtë praktikë, unë besoj që ky është dokumentacion që e ka administruar KZAZ—ja. Maksimumi që mund të jetë në këtë praktikë është që subjekti çon vetëm një anëtar të këtij komisioni.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. K. Bele: Në vazhdim të pyetjes zotit Rusmali, ka ndonjë diferencë për subjektin caktimi i anëtarit të kësaj QV-je nga anëtarët e 54 QV-ve të tjera? 1-2 anëtarë sa keni ju?

Z. E. Salianji: Nga përfaqësuesi ynë në KZAZ, ne kemi vëzhgues si Parti Socialiste. Na është njoftuar nga KZAZ –ja që duhet të sillni komisionerët e qendrës së votimit për të gjithë qendrat e votimit, përfshirë edhe qendrën e burgut.

Z. K. Bele: Dakord, këtu, më fal, tani kjo qendër ka qenë në zgjedhjet e kaluara të 22-shit, 21-shit, 90-s.

Z. E. Salianji: Kjo qendër ka qenë 13, 15, 19 mund të ketë qenë edhe më përpara po deri në 13 që kam verifikuar, ka qenë.

Z. K. Bele: Pra, është korrekte, siç e kuptoj unë, që subjekti politik në këtë rast subjektit tuaj, besoj e njëjta pyetje është edhe për ju, i vjen lista e qendrave dhe subjekti sjell listën e komisionerëve, duke e marrë të mirëqenë që qendrat janë ato që historikisht kanë funksionuar. Ky është roli i subjektit.

Z. E. Salianji: Po, pra nëpërmjet vëzhguesit, thashë, është thënë KZAZ-ja që keni afat 30 ditor të sillni anëtarët e qendrës së votimit, duke raportuar se cili është numër tek dhe çift, se aty është edhe kur ke shumicën dhe tek dhe çiftet. Pra, është bërë një sqarim, se partitë politike e kanë lëshuar kryetarin ose në raste të tjera sekretarin duke orientuar KZAZ-ja se ku e kanë kryetarin dhe ku e kanë sekretarin. Pra, nuk e kemi çuar ne se i ndau vetë, vetë KZAZ-ja ka thënë në këto qendra keni kryetarin,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

në këto qendra keni sekretarin, sillni propozimet dhe për sekretarin ta kini jurist, për kryetarin, me shkollë të lartë etj, etj.

Z. Y. Merkaj: Mendoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vetëm një rol këtu, në qoftë së do të verifikojë qendrën e votimit, që është përcaktuar nga kryetari i bashkisë, në qoftë se i plotëson kërkesat e nenit 62 pika 2, a ka më shumë se 15 zgjedhës apo jo, këtë bën KQZ-ja dhe në qoftë se ka më shumë se 15 zgjedhës, atëherë i jep KZAZ-së udhëzimet për të ngritur komisionin e qendrës së votimit.

Z. L. Braho: Po në 2022 keni marrë vendim për krijimin e KQV –së së posaçme dhe sasinë e fletëve të votimit për qendrën e posaçme të votimit nr. 22 -24/1. Në këto zgjedhje ka një vendimmarrje të tillë?

Z. Y. Merkaj: Jo, nuk ka.

Z. L. Braho: Po pra për 40 ditë dhe e kanë bërë këtë, tani për 6 muaj dhe s'e kanë bërë.

Z. Y. Merkaj: Nuk e di nuk ka vendim, sepse është bërë vendimi nga kryetari i bashkisë, për krijimin e qendrës së posaçme.

Z. I. Rusmali: Me aq sa kemi dijeni ne, te Komisioneri diskutohen vendimet për krijimin e qendrave në përgjithësi, domethënë palët politike sjellin propozime për modifikime, për ndryshime, për heqje, për shtime qendrash votimi. Për këtë zonë zgjedhore ka pas diskutime të kësaj natyre te komisioneri, ka marrë vendimmarrje komisioneri për këtë zonë zgjedhore, dhe eventualisht për këtë qendër votimi pastaj?

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. Y. Merkaj: Procedura për qendrat e votimit është e tillë: kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, kryetari i bashkisë, në rastin konkret, bëjnë propozimet për krijimin vendndodhjen e qendrave të votimit. Ai që diskuton Komisioneri është ndryshimi i vendndodhjeve nga qendrat publike në private, dhe caktimi i KQZ-së 40 ditë para ditës së zgjedhjeve, ndryshimi i vendosjes së qendrës së votimit 40 ditë para zgjedhjeve. Kjo bëhet me autorizim të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rastet e tjera krijohen nga kryetari i bashkisë.

Z. K. Bele: Në vitin 2022, një gjë të kuptohemi, meqenëse na u mor si rast studimor, keni autorizuar KZAZ-në e Rrogozhinës 43 të marrë fletë votimi nga 4 QV-të e tjera dhe të dorëzojë tek kjo QV. Pra janë marrë 60 fletë votimi për pajisjen e QV-së. Nëse e kuptoj drejt s'ka pasur fletë votimi të printuara për këtë QV.

Z. Y. Merkaj: Kjo është praktikë që ndjek KQZ-ja në të gjitha qendrat e votimit kur mungojnë fletët e votimit, për shembull, është nga fabrika ku porositen fletët e votimit i mungon një qendre votimi, mos të ketë fare fletë votimi, atëherë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bën një zgjedhje që merr 20% ose 10% nga 2, 3 qendra të votimit fqinj dhe i plotëson numrin e zgjedhësve për të votuar, për të mos humbur të drejtën e votës zgjedhësit në atë QV.

Z. K. Bele: Pra në këtë zgjedhje, disa ditë se nuk e gjej dot sa ditë para zgjedhjeve, është bërë kjo praktikë për të plotësuar me fletë votimi QV-në.

Z. Y. Merkaj: Sepse nuk ka pasur, s'janë prodhuar fletë votimi për këtë qendër votimi.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. K. Bele: Pra, ky është një rast i veçantë, i cili lidhet me situatën e zgjedhjeve të të parakohshme në Bashkinë e Rrogozhinës për një situatë të ndryshme nga kjo.

Z. Y. Merkaj: Ka dhe raste Elbasani, ka dhe 2, 3 raste të tjera.

Z. I. Rusmali: Do të thotë që kjo qendër votimi s'ka qenë e planifikuar, bashkë me të tjerat është shtuar mbrapa.

Z. Y. Merkaj: Po flasim për 2022-shin, po.

Z. I. Rusmali: 2022-shin ka qenë kështu, nuk ka qenë e planifikuar, është shtuar rrugës, siç ka ndodhur këtë herë me Belshin.

Z. L. Braho: Atëherë, zoti Gumi, fjala për ju në qoftë se keni ndonjë pretendim tjetër, në të kundërt në qoftë se palët s'kanë pretendime të tjera vijojmë me konkluzionet përfundimtare.

Z. I. Kaso: S'kemi pretendime të tjera lidhur me thellimin e imtë administrativ përveç ezaurimit të kësaj pike, ashtu siç tha dhe kolegu Gumi, në qoftë se s'kanë palët e tjera vazhdojmë, si ta shikoni ju.

Z. L. Braho: Zoti Selianji, ju keni gjë tjetër?

Z. Salijani : Jo. Vazhdojmë.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. L. Braho: Dakord. Atëherë ftojme palët për konkluzionet përfundimtare. Çfarë kërkoni përfundimisht nga KAS-i.

Z. I. Kaso: I qëndrojmë kërkesës, që kemi ngritur në kërkesën fillestare me anë të së cilës kemi investuar KAS-in, ku pjesa e parë e rinumërimit dhe e rivlerësimit dhe e përfshirjes në rezultat të rezultatit dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi u ezaurua gjatë shqyrtimit të hetimit administrativ dhe kërkojmë që tabela përfundimtare, le të themi, të administrohet siç u administrua, dhe të përbëjë tabelën mbi bazën e të cilëve duhet të aplikohet kërkesa jonë e dytë, që vlerësojmë se është e ligjshme, e bazuar në ligj, në kod, në praktikë dhe duhet të pranohet dhe ajo gjithsesi, për heqjen e qendrës së burgut nga tabela përfundimtare e zgjedhësve dhe mospasqyrimin e këtij rezultati në rezultatin përfundimtar. Arsyet janë ato tek të cilët u ndalëm gjerësisht në procesin e relatimit të kërkesës sonë, por dhe nga sa doli nga shqyrtimi administrativ dhe nga ezaurimi i debatit të fundit, i cili përbëri edhe momentin e fundit të shqyrtimit administrativ, ku u vërejt qartë dhe nga përgjigja e administratës fakti që kemi të bëjmë me një qendër, e cila nuk është ngritur sipas parashikimeve të Kodit Zgjedhor, i cili rregullon në mënyrë të detajuar, sikundër dhe praktika që u paraqit këtu me cilësinë e njohjes, por që administrohet në origjinal nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mënyrën sesi janë ngritur këto qendra në të kaluarën dhe si vazhdojnë e ngrihen këto qendra të posaçme në institucionet e vuajtjes së dënimit. Ajo çka rezulton e qartë si dritë e diellit, edhe nga referenca që bëri edhe kolegu i Partisë Socialiste në dispozitën përkatëse, te e cila referonte neni 62, pra për ngritjen e qendrave të votimit atje ku referonte te dispozita për publikimin e ekstrakteve zgjedhore, vërehej që detyrimi për Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile ishte që të pasqyronte në një qendër të caktuar, qoftë kjo edhe qendër e posaçme të gjithë zgjedhësit që kishin vendbanimin në atë zonë zgjedhore, në atë zonë qendre votimi,

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

në rastin konkret, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe nuk ka ndodhur as në datën 23 mars, ku me anë të shkresës, të cilën ia vumë në dispozicion KAS-it, është vetë drejtori i këtij institucioni të vuajtjes së dënimit, i cili ka paqartësinë në qoftë se ata zgjedhës duhen të votojnë ose jo për këto zgjedhje dhe në rast se po, ku duhet të votojnë pasi në përgjigje të detajuar të drejtorisë së burgjeve, cila gjithashtu ua vumë në dispozicion, rezulton se përkundër asaj çka pretendohet, që është ngritur një qendër në një institucion të vuajtjes së dënimit, se besoj që ky ishte pretendimi përfundimtar i kolegut të Partisë Socialiste, pra që është ngritur nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore për inerci të situatave të zgjedhjeve të kaluara, një qendër me fraksion, një qendër e posaçme në institucionin e vuajtjes së dënimit, përsëri nuk respektohet edhe kriteri numerik, ku kërkohet që në institucionet e posaçme të vuajtjes së dënimit, qendra e posaçme ngrihet kur ka më shumë se 15 zgjedhës, siç e referon edhe ligji, pa u ndalur këtu se kush duhet ta propozojë e kush duhet ta ngrejë, po edhe sikur të marrim të mirëqenë që kjo qendër ngrihet për shkak të iniciativës së kryetarit të njësisë qeverisjes vendore, kriteri numerik që parashikon ligji, pra 15 zgjedhës me të drejtë vote në këtë qendër, pra 15 zgjedhës të cilët ta kenë vendbanimin në ditën që ngrihet qendra e votimit, pra, qendra e posaçme, ta kenë vendbanimin në atë zonë zgjedhore, mbi të gjitha, pra në Bashkinë Rrogzhinë, dhe për më tepër në atë zonë qendër votimi, pra me një kod unik banese. Në rastin konkret asnjëri nga këto kriterë nuk plotësohet pasi është vetë Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve që na informon që nga të gjithë shtetasit, që kanë votuar në këtë institucion të vuajtjes së dënimit, në datën 25 mars vetëm 2 prej tyre e kishin vendbanimin në Bashkinë Rrogzhinë, pra jemi jashtë gjithë kriterëve ligjore. Praktikisht kemi të bëjmë me rastin kur në një qendër fantazmë, për efekt të ligjit, kanë votuar zgjedhës, gjithashtu, fantazmë për efekt të ligjit, çka kurrsesi nuk mund të prodhojë në këndvështrimin tonë një rezultat të drejtë, një rezultat të ligjshëm, një rezultat të numërueshëm, i cili të japë efektet e

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

veta dhe efekte ka dhënë, sepse rezultati dihej fare qartë përpara tabulimit të kësaj qendre dhe është një rezultat ka ndryshuar thjesht dhe vetëm për efekt të kësaj qendre, e cila as është ngritur në përputhje me dispozitat ligjore, as ka patur qartësi deri në fund nga vetë institucionet që administrojnë procesin, se duhet të votonin zgjedhësit në këtë qendër ose jo dhe nuk dihet mbi bazën e cilit kriter vendbanimi janë lejuar zgjedhësit të votojnë. Ne besojmë me forcë se e drejta e votës duhet të bëhet efektive në mënyrë të njëjtë shtetasve, të cilët vuajnë dënim në institucionit e vuajtjes së dënimit, qofshin këto paraburgime, burgje, qofshin institucione spitalore. Pra, nuk duhet të diskriminohen nga e drejta e votës për këtë arsye, po sigurisht ata nuk mund të privilegjoohen, duke u garantuar kritere të tjera ose lehtësira të tjera shtesë në raport me zgjedhësit e tjerë, të cilët nuk vuajnë dënimin në këto institucione. Prandaj në qoftë se mbas përfundimit të afishimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, shtetasve të tjerë nuk u lejohej që të bëjnë ndryshime qoftë këto edhe me vendime gjykate, në qoftë se vendbanimi i tyre nuk ka ndryshuar përpara momentit përfundimtar, pra të hartimit të listës përfundimtare të zgjedhësve, nuk shoh që përse për shtetasit, të cilëve u lejohej që të votojnë në këto institucione mundet të kenë lirinë që t'i shmangen kriterit rigoroz të vendbanimit, me të cilin e lidh të drejtën e votës për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore qoftë Kodi Civil, qoftë ligji për gjendjen civile, qoftë Kodi Zgjedhor dhe të gjitha aktet nënligjore, që detajojnë në mënyrë shteruese dhe momentin e ndryshimit të tyre të vendbanimit për efekt ligjit. U ndalëm në seancën e kaluar në ilustrimin e akteve nënligjore dhe detyrimeve që i lindin administratës, qoftë kjo administratë e burgjeve, qoftë gjendja civile, të cilët kanë detyrime në bazë të akteve nënligjore se si duhet të marrin masa që t'u garantohet dhe t'u bëhet efektive e drejta e votës shtetasve të cilët vuajnë dënimin në institucionet e vuajtjes së dënimit dhe shohim që qoftë për fajin të administratës së burgjeve, veprime apo mosveprimet e tyre, qoftë për faj të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

administratës së gjendjes civile, qoftë për faj të gjithkujt që ka patur detyrimin, po nuk e ka vënë ujin në zjarr që këta shtetas të votojnë në atë institucion, pra të kenë mundësi që pranë këtij institucioni të ngrihet një qendër e posaçme dhe të votojnë, nuk shoh që përse të gjitha këto shkelje të ligjit na sillkan në përfundim një rezultat të pranueshëm nga të gjitha, aq më tepër të certifikueshëm, siç është ngritja e një qendre të posaçme pa vendimmarrje të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndryshe nga praktika e mëparshme, pa një listë përfundimtare zgjedhësish, e cila të kishte dalë në përputhje me dispozitat ligjore, ligjin për gjendjen civile dhe Kodin Zgjedhor dhe si i tillë ky rezultat, i cili vjen si pasoje e një sërë paligjmërisht që janë konsumuar nga institucione të ndryshme nuk ka kurrësi të prodhojë një tabelë numërimi të vlefshme, një tabelë e cila përfshihet në rezultatin përfundimtar. Prandaj kërkesa jonë mbetet e njëjta për sa i përket këtij momenti shumë të rëndësishëm dhe deciziv për sa i përket procesit me atë që ka qenë që në kërkesën fillestare, pra që rezultati i prodhuar nga kjo qendër votimi të mos rezultojë në rezultatin përfundimtar dhe të hiqet në kolonën përkatëse rezultati i kësaj qendre. Në këtë mënyrë mund të kemi një tabelë të saktë, një tabelë të qartë që të jemi të sigurt se pasqyron vullnetin vërtet të zgjedhësve, të shtetasve me drejtë vote, sipas të gjitha dispozitave ligjore të asaj njësie qeverisje vendore shtetas, të cilët kanë folur qartë dhe e kanë shpallur fituesin e tyre. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Kaso! Tani që të jemi të qartë ju kërkoni pavlefshmërinë e listës të kësaj qendre votimi dhe duke qenë se sipas jush janë më pak se 15 të burgosur me banim në Bashkinë e Rrogozhinës, atëherë aty nuk duhet të kishte fare qendër votimi. Ky është thelbi i prezantimit tuaj në lidhje me faktin që ta konsiderojmë të pavlefshme zgjedhesh apo pavlefshme liste.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. I. Kaso: Jo pavlefshmëri zgjedhjesh. Nuk e kemi artikuluar pavlefshmërinë e zgjedhjeve në raport me nenin 160-161 e vijues, sepse për vetë natyrën e saj pavlefshmëria që ne kërkojmë e këtyre veprimeve administrative, të cilët kanë lejuar në mënyrë të gabuar të votojnë në këtë qendër zgjedhës të cilët nuk kishin të drejtë për të votuar, është e ndryshme nga ajo që flet neni 160 e vijues. Pasi e dyta për vetë natyrën e saj konsumohet kryesisht ditën e zgjedhjeve dhe pasojat e saj, në qoftë se ndikojnë në rezultat, janë të rikuperueshme nëpërmjet një procesi përsëritje zgjedhjesh me të njëjtët kandidatë, me të njëjtët zgjedhës, me të njëjtën listë zgjedhësish etj, etj., Pra i rivë edhe një herë në të njëjtat kushte. Në qoftë se për paradoks do të urdhërohej përsëritja e zgjedhjeve përsëri nuk do të “shërohej” kjo paligjshmëri ligjore, që ka ndodhur për sa i përket që momentit të hartimit të listës zgjedhësve dhe të gjithë procedurat e tjera administrative të cilat kanë vijuar dhe kanë prodhuar një rezultat që gjithçka mund të jetë, po rezultat ligjor për këtë zonë jo. Ju faleminderit!

Z. L. Braho: Dakord, faleminderit! Ju, zoti Gumi, në cilësinë e përfaqësuesit e palës së interesuar ndonjë gjë shtesë.

Z. V. Gumi: Faleminderit! Thjesht për t’ju treguar, duke qenë edhe ekspert që jam marrë me këtë çështjen e zgjedhjeve, në një bisedë me një ekspert të ODIHIR-it të Komisionit të Venecias, në këto takimet tona na është përmendur që unë në leksionet e mia në Gjermani i jap Dushkun, dhe Dushku ka qenë fenomeni tipik shqiptar i votës taktike, e cila u shndërrua në atë dimension sa që u bë edhe model për leksionet në të drejtën elektorale. Kam frikë që edhe në këtë rast, ne do të duhet të japim një leksion për të drejtën elektorale, thelbi i së cilës është ky: 1. Në një qytet vendosin për t’u qeverisur për 4 vite jo banorët që paguajnë taksa në atë qytet, por vendosin

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

disa individë, të cilët tagencialisht janë me vendqëndrim në atë vend. U përmend pak më parë dhe u theksua që argumenti ynë kryesor ka të bëjë me konfliktin e ligjeve. Ne jemi përpara një trupe kuazi gjyqësore dhe kërkojmë që kjo trupë kuazi gjyqësore të veprojë siç vepron gjykata dhe gjykata e ka detyrim kushtetues që në një konflikt midis një ligji me 3/5-at dhe një ligji me shumicë të thjeshtë, të zbatojë drejtpërdrejt ligjin me shumicë të cilësuar. Kodi Civil është dispozitë e plotë për vendqëndrimin, është dispozitë e plotë për vendbanimin dhe në asnjë moment dhe në asnjë rast nuk delegon hartimin e një dispozite tjetër për të përcaktuar vendbanimin jashtë kriterëve të Kodit Civil. Kjo do të thotë që zgjedhjet në atë zonë janë bërë, përpos argumenteve që përmendi kolegu pak më parë, është shkelje flagrante e ligjit dhe nuk duhen marrë parasysh. Ne po diskutojmë çështjen që ka të bëjë me 20, 21 vota 10, 15 vota diferencë, do të thotë që i kemi hyrë në qelizë procesit dhe kemi parë edhe momentin më të vogël se si ndikon ajo. Po bukuri e kemi një qendër votimi, po kush e krijoi komisionin e qendrës së votimit? Biem dakord u krijua qendra e votimit në burg, kush e krijoi komisionin? A mund të bëhet në një qendër votimi votime pa komision? Ndryshe është krijimi, ndryshe është përbërja. Vendoset krijimi pastaj forcat politike propozojnë mbushjen me këtë gjë, cedojmë në praktikën administrative, cedojmë në praktikën gjyqësore, cedojmë në praktikën e standardit ndërkombëtar. Nuk ka asnjë vend që të ketë këtë praktikë. Ne po biem ndesh edhe me vendimin e vetë Gjykatës Kushtetuese për këtë gjë. Ka sqaruar konceptin e vetëqëndrimit, ka sqaruar konceptin e vendbanimit, me fokus të posaçëm institucionet e vuajtjes së ekzekutimit të vendimeve penale dhe ka nxjerrë pikërisht ligjore, kushtetuese përcaktimin që ka bërë Kodi Civil në lidhje me këtë drejtim. Këto ishin argumentet, shkurtimisht, se unë nuk dëshiroj të bie në përsëritje të atyre që përmenda pak më parë.

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Gumi! Fjala për përfaqësuesin e Partisë Socialiste.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

Z. E. Saliانji: Po faleminderit! Për sa i përket objektit të këtij shqyrtimi, ne kërkojmë që KAS-i të vendosi ndryshimin e vendimit të KZAZ-së, duke shpallur fitues kandidatin e Partisë Socialiste, me rezultatin e dalë nga rinumërimi dhe rivlerësimi. Për sa i përket pikës së parë. Për sa u përket argumenteve që parashtron ankuesi, ne siç kemi thënë edhe gjatë shqyrtimit administrativ, të burgosurit nuk janë skllëvër, të cilët 2000 vjet më parë nuk lejoheshin të votonin, të burgosurit janë disa persona të cilët me vendimin e gjykatës ju është privuar liria e tyre dhe ndodhen në burg, por nuk u është privuar liria e votës. Nuk thotë në asnjë dispozitë as të ligjeve të posaçme, as të Kodit Zgjedhor që një i burgosur nuk duhet të votojë. Kushtetuta e ka fare të qartë si e drejtë kushtetuese për të votuar, por dhe mënyrën se si një i dënuar nuk mund të votojë, kur ka një dënim për të mos votuar. Vetëm kjo është ajo që e bën një të burgosur t'ia heqë të drejtën për të votuar. Për sa i përket vendqëndrimit, vendbanimit, e diskutuam në seancën e parë, e diskutojmë edhe këtu, është zgjidhur mbas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të 2007, ligji për gjendjen civile 2010, neni 18 e ka sqaruar fare qartë: qëndrimi më shumë se 3 muaj në një ambient burgimi quhet adresa dhe vendbanimi i të dënuarit, dhe që kjo e ka mbyllur diskutimin për sa i përket shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese për të përdorur si argument. Për sa i përket mënyrës se si është ngritur komisioni i qendrës së votimit, shpallja e listave kjo qendër votimi nuk është ngritur. Mua më vjen shumë keq që ndodhi ky rezultat, që ne jemi këtu, pra që diskutohet vota e atyre të burgosurve, pavarësisht për mua është e njëjtë në votë, e barabartë me votën e qytetarit të Rrogozhinës, se edhe ata janë njerëz, që të drejtën e votës e kanë të barabartë, por ky rezultat bën që ne ta diskutojmë këtu dhe të merremi me mënyrën e formimit të kësaj qendre. Janë prodhuar lista për këtë qendra votimi, janë prodhuar vula për këtë qendër votimi, janë emëruar komisionerë për këtë qendër votimi. Kjo qendër votimi

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt.5.06.2023*

ka shtatë palë zgjedhje që ekziston aty dhe asnjëherë nuk është ankuar as Partia Demokratike në atë kohe as kjo që është tani, që ankohen, as ankuesit, s'ka pasur asnjëherë problem, siç nuk janë ankuar për qendrat e votimit të burgut të Peqinit. Këtu jemi, shqyr që nuk është ky rezultat. Pse nuk janë ankuar? Këtu ne kemi ankesë nga Partia Demokratike dhe nga përfaqësuesit e Koalicionit Bashkë Fitojmë për një aktivitet që ka bërë kryetari i Bashkisë së Rrogozhinës, me dhjetëra ankesa. Si ka mundësi të mos vinte një ankesë për ngritjen e një qendre votimi në kundërshtim, siç pretendohet në ligjin, që për mua kjo qendër është konform ligjit si gjithë qendrat e tjera. Pra, po të shikohet praktika e kryetarit të bashkisë, i cili e ka krijuar këtë qendër votimi mbas kërkesës së drejtorisë së burgjeve etj, etj dhe më pas KQZ –ja, me veprime konkludente ka miratuar listën, ka miratuar vulat. KZAZ-ja ka ngritur qendrën e votimit, se nuk është ngritur përbërja e qendrës së votimit me hamendje. Këtu jemi përballë faktit që sot po diskutojmë vendimin i KAS-it. Në qoftë se do të ishin në të kundërt, do të vinte me dyshim, kanë të drejtë të burgosurit (nuk kuptohet) të votojnë apo jo? Pra, mundet ne ta ndryshojmë Kodin Zgjedhor me një vendim të KAS-it. Jo, nuk mund ta ndryshojmë. Prandaj, ju lutem, për sa më sipër kërkoj që vendimi të ndryshohet duke shpallur rezultatin sipas rezultatit që doli nga tabelat e grupit të numërimit. Faleminderit!

Z. L. Braho: Faleminderit, zoti Salianji! Atëherë KAS-i do të tërhiqet për vendim dhe vendimin do ta shpallim nesër në orën 12:15. Seancën e deklaroj të mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

